



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për raportimin e veprimtarisë vjetore për vitin 2018

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Alban Zeneli, Andi Permeti, Edmond Leka dhe Adriatik Alimadhi

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Aurora Mara, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar :

Erinda Ballanca – Avokate e Popullit
Enio Haxhimihali – Drejtor Kabineti tek Avokati i Popullit
Fatbardh Zenelaj – Sekretar i Përgjithshëm te Avokati i Popullit
Kledia Ngjela – Këshilltare te Avokati i Popullit
Ermonela Xhafa – Komisionere e MKPT-së
Ermonela Ruspi – Komisionere në Seksionin e Veçantë
Erjona Canaj – Komisionere në Seksionin e Administratës
Nejla Peka – Komisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
Vilma Shurdha – Komisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Alket Jaupi – Ndihmëskomisioner

Marine Bushe – përfaqësuese e zyrës së Koordinatorit të Organizatës së Kombeve të

Bashkuara

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përsëritje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kourumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës, ku sot kemi seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për veprimtarinë vjetore për vitin 2018. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Spartak Braho.

Raportimi dhe monitorimi i institucioneve kushtetuese të pavarura është pjesë e rëndësishme e punës së Komisionit të Ligjeve në drejtim të ushtrimit të kontrollit parlamentar.

Materiali që ka sjellë Avokati i Popullit në lidhje me veprimtarinë e tij për vitin 2018 u është shpërndarë kolegëve deputetë nëpërmjet postës elektronike që në momentin që ka ardhur në Kuvend, por është edhe sot në tryezën e këtij komisioni.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe ne kemi prezent zonjën Erinda Ballanca, Avokate e Popullit. Zonja Ballanca, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Prezent kemi zonjën Ermonela Xhafa, komisionere, zonjën Ermonela Ruspi, komisionere, zonjën Erjona Canaj, komisionere, zonjën Nejla Peka, komisionere dhe zonjën Vilma Shurdha, komisionere, si dhe stafin ndihmës të Avokatit të Popullit, si: zotën Haxhi Mihali, drejtor kabineti, zotën Zenelaj, sekretar i Përgjithshëm dhe zotën Jaupi, ndihmëskomisioner. Po ashtu kemi edhe një përfaqësuese të zyrës së Koordinatorit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, zonjën Marine Bushe.

Faleminderit për prezencën tuaj në komision!

Pa humbur kohë do t'ia kaloj fjalën zonjës Ballanca për të bërë një prezantim të shkurtër të veprimtarisë vjetore që ky institucion ka zhvilluar për vitin 2018.

Të nderuar kolegë,

Më lejoni t'ju them se për vitin 2018 ne kemi pasur në dinamikë raporte periodike nga Avokati i Popullit për problematika të caktuara. Këto raporte u janë vënë në dispozicion, sipas fushës së përgjegjësisë që kanë, nënkomisioneve të Komisionit të Ligjeve dhe deputetëve.

Gjithsesi, zonja Ballanca, mund të bëni një sintezë të të gjitha problemeve dhe gjetjeve që ju keni konstatuar në veprimtarinë tuaj për vitin 2018 dhe do t'ju lutesha të fokusoheshit në ato probleme që ju mendojnë se duhen bërë të ditura për kolegët dhe opinionin publik, që t'u japim mundësinë kolegëve deputetë të bëjnë pyetje. Në parantezë, ju vë në dijeni se shumë nga kolegët e mi kanë pyetje për veprimtarinë e institucionit që ju drejtoni dhe dua t'u japim kohën e duhur.

Fjala për ju.

Erinda Ballanca – Faleminderit, zoti Manja!

Avokati i Popullit e vlerëson veçanërisht vëmendjen që Komisioni i Ligjeve u ka dhënë çështjeve të të drejtave të njeriut gjatë vitit të kaluar, duke pasur një bashkëpunim, për hir të së vërtetës, nga më shembullorët.

Unë personalisht, komisionerët e emëruar, por edhe stafi i institucionit mendon se vetëm një bashkëpunim i vërtetë institucional mundet ta çojë përpara zbatimin e çështjeve të të drejtave të njeriut.

Secili nga ne ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta dhe sigurisht që ne i kuptojmë detyrat, përgjegjësitë dhe kufizimet e Kuvendit për sa u përket disa prej kërkesave tona, por nga ana tjetër është shumë e rëndësishme që fryma e bashkëpunimit ta çojë përpara çështjen e të drejtave të njeriut.

Ne mendojmë se, pavarësisht vullnetit dhe dëshirës së çdo institucioni apo grupimi për të mbrojtur të drejtat e njeriut në këtë vend, Avokatit të Popullit është institucioni që jep një kontribut të pazëvendësueshëm në përpjekje për të mbrojtur shtetasit e tij dhe për të zhvilluar një kulturë, që respekton dhe zhvillon të drejtat e njeriut.

Ne kemi përgatitur një raport të përmbledhur, i cili ka marrë parasysh komentet që janë bërë nga Komisioni i Ligjeve vitin e kaluar, të cilat kanë qenë të vazhdueshme. Për herë të parë ju nuk keni një raport deskriptiv për çdo rekomandim, por për secilën nga 5 fushat që Kuvendi dhe ligji ka përcaktuar si fusha thelbësore në të cilat ndahet aktiviteti ynë, pra janë çështjet më problematike apo çështje që Avokati i Popullit gjykon se janë prekur interesat e një grupi më të gjerë personash, të cilat kanë shënuar punën tonë.

Më duhet të them se me kapacitetet që kemi nuk ia dalim dot që të realizojmë pritshmërinë e publikut. Pritshmëria e publikut është shumë e madhe për punën dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, prandaj ne jemi vënë në mënyrë të vazhdueshme nën një presion jo të vogël si nga mediet, por edhe nga çdo qytetar. Këtë besoj se nuk e kemi vetëm ne si institucion, por edhe ju si Kuvend dhe të gjitha institucionet e tjera për të rritur mirëqeverisjen. Në këtë kuptim mendoj se secili nga ne duhet të rrisë përgjegjësinë personale për kryerjen e një performance sa më të mirë të punës, por nga ana tjetër duhet të shikojmë mundësitë dhe kapacitetet reale për të bërë të mundur zbatimin e kësaj detyre që kemi si institucion.

Gjithashtu, një tjetër kujdes që ne kemi pasur është dhe natyra e rekomandimeve. Një pjesë e mirë juaja kanë tërhequr vëmendjen se rekomandimet e Avokatit të Popullit duhet të jenë më thelbësore për çështje, të cilat vërtet janë probleme të qenësishme të të drejtave të

njeriut. Në këtë kuadër cilësia e rekomandimeve që kemi dhe paraqitja e tyre është përmirësuar ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme, duke trajtuar të gjitha kërkesat që vijnë nga qytetarët, edhe për çështje të thjeshta. Pra, ne nuk kemi neglizhuar asnjë ankesë të ardhur, por jemi munduar të përgatisim raporte të veçanta për në Kuvend dhe një qasje të re të problematikave të të drejtave të njeriut, duke u munduar të kemi zbatimin e standardeve më të larta. Për këtë na ka ndihmuar mekanizmi, i cili është duke u aplikuar nga Kuvendi, pra mekanizmi për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura, i cili, ndonëse është në hapat e parë po rezulton se ka një rritje të përgjegjësisë nga ana jonë për të bërë rekomandimet e duhura.

Unë mendoj se për të adresuar këto problematika përgjegjësia në momentin e parë nis nga ne, por edhe nga institucionet e tjera. Nga organet e administratës shtetërore duhet një vëmendje më e madhe për t'iu përgjigjur në kohë rekomandimeve dhe kërkesave që ne bëjmë.

Gjatë vitit 2018 ne kemi adresuar në total 171 rekomandime drejtuar organeve të administratës publike, duke përfshirë edhe ato qendrore e vendore. Nga numri total i rekomandimeve rezulton se 93 rekomandime janë pranuar, 17 rekomandime janë refuzuar, 5 rekomandime janë pa përgjigje dhe 56 rekomandime janë në proces. Këto të dhëna janë përcaktuar deri në momentin që kemi paraqitur raportin.

Nisur nga analiza e statistikave të mësipërme, për vitin 2018 rezulton se ka një ulje të numrit të rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucionet e administratës publike, por kemi edhe një rritje në përqindje të rekomandimeve të zbatuara, sepse më parë kishte rekomandime që ishin pranuar, por nuk zbatoheshin. Pra, fakti i pranimi të rekomandimeve nuk sjell atë ndikim që duhet në jetën e qytetarëve, prandaj gjykojmë se vetëm rekomandimet e zbatuara janë ato që sjellin ndryshim në jetën e qytetarëve.

Lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2018 janë më pak rekomandime pa përgjigje krahasuar me vitin 2017.

Gjatë këtij viti institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 5516 ankesa. Pra, është një lumë me ankesat e qytetarëve, të cilat adresohen te ne. Këto janë ankesa, kërkesa dhe njoftime, përfshirë edhe ato që janë në pritje të qytetarëve, nga të cilat 2601 ankesa kanë qenë pjesë e objektit të punës së institucionit të Avokatit të Popullit dhe janë cilësuar brenda juridiksionit dhe kompetencës.

Gjatë vitit 2018 në shqyrtimin e ankesave të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit rezultojnë se janë trajtuar 1831 ankesa, nga ku rezulton se 173 ankesa kanë qenë jashtë juridiksionit, 290 ankesa janë jashtë kompetencës, 556 ankesa janë të pabazuara, 55 ankesa

prej të cilave është hequr dorë, 743 ankesa janë të pranuar e të zgjidhura në favor të qytetarëve dhe 14 ankesa të refuzuara.

Sipas seksioneve që kemi paraqitur në përmbledhjen tonë rezulton se seksioni i administratës ka 886 ankesa, seksioni i fëmijëve ka 170 ankesa, seksioni i veçantë ka 880 ankesa, seksioni i përgjithshëm 585 ankesa dhe nga mekanizmi për Mbrojtjen nga Tortura ne kemi shënuar 80 ankesa, por në të vërtetë janë inspektime të kryera, sepse ata nuk marrin drejtpërsëdrejti ankesa apo trajtojnë vetëm pak ankesa nga qytetarët. Këto ishin të dhënat statistikore, të cilat i kemi paraqitur në raport.

Për sa u përket problemeve të zbatimit të të drejtave të njeriut, mendoj se në krye të kësaj liste është mungesa e një sistemi efektiv drejtësie për të garantuar të drejtat e njeriut. Pra, mungesa efektive e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Lartë ka qenë problemi thelbësor në garantimin e të drejtave të njeriut në vend dhe mbetet në vijim edhe gjatë këtij viti.

Zbatimi i reformës në drejtësi është një prioritet kombëtar, që duhet të sjellë rezultatet e duhura për publikun dhe këto pengesa duhet të adresohen në mënyrë të menjëhershme nga Kuvendi për të bërë të mundur realizimin efektiv të qëllimeve të reformës në drejtësi.

Reforma në drejtësi është konsideruar nga Avokati i Popullit si kryereforma e gjithë këtyre viteve demokraci. Në këtë kuadër mendojmë se nuk duhet shkëputur vëmendja dhe përkushtimi që kjo reformë të arrijë ato rezultate, të cilat priten nga qytetari, pra një drejtësi më cilësore dhe në kohë.

Ne si institucion kemi dhënë kontributet tona maksimale konstruktive, pavarësisht se ky ka qenë një mandat i ri dhe atipik për institucionin tonë, për të garantuar të drejtat e të gjithë aktorëve në këtë reformë, por edhe për të dhënë kontributin tonë modest, me aq sa mundemi, që reforma të realizohet në mënyrën më të përshtatshme. Gjithsesi, ky mbetet një problem thelbësor, i cili duhet të adresohet.

Një çështje tjetër, ku ne kemi gjetur shumë probleme, është edhe efektiviteti i zbatimit të ligjit, i cili rezulton që ka shumë problematika në kuadër të ligjeve për implementimin e reformës. Por me arritjen e kuorumeve shpresojmë të ecim përpara në trajtimin e problemeve që kanë dalë në praktikë, për të ndryshuar ligjet dhe për të adresuar ato probleme që realisht e kanë bërë pothuajse të pamundur zbatimin e reformës brenda afateve të përcaktuara në ligj. Pra, reforma nuk po ecën sipas afateve që ju si ligjvënës keni përcaktuar në ligj, prandaj duhet të ketë një adresim thelbësor nga të gjithë ne.

Ju raportin e keni, por dua që vëmendja juaj të fokusohet në tre apo katër elementet më thelbësore, të cilat i kemi trajtuar në mënyrë të përmbledhur.

Problematikat e para që ne kemi hasur kanë të bëjnë me sistemin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Në këtë kuadër, pavarësisht se ka pasur një përmirësim të mbipopullimit, sepse çështjet e mbipopullimit janë adresuar në krahasim me vitet e kaluara, konstatohet se ngelet problem thelbësor çështja e trajtimit mjekësor, si dhe cilësia e shërbimit mjekësor në burgje.

Në gjykimin tonë ka vonesa edhe në përmbushje të kriterit ligjor për vuajtjen e dënimeve në institucione që janë më afër vendbanimit të të burgosurve, pavarësisht faktit se mbipopullimi është adresuar.

Problemi tjetër thelbësor, për sa u përket të drejtave të personave që janë në sistemet e vuajtjes së lirisë, ka të bëjë me personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Për këtë problem, që ne e konsiderojmë thelbësor, nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare, pra për të përgatitur një ambient spitalor jashtë ambienteve të burgjeve për mjekim të detyruar të këtyre personave. Në këtë aspekt janë duke u bërë përpjekje, por gjithsesi ky problem mbetet shqetësues.

Përveç kompleksitetit dhe vështirësisë për të provuar rastet e ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të burgjeve, ka pasur raste ku është arritur të provohet ushtrimi i dhunës nga punonjësit e policisë së IEVP-ve, për shembull në policinë e burgjeve në Fushë-Krujë, për të cilën ne kemi bërë edhe adresimet përkatëse në organet kompetente.

Parandalimi i fenomenit të vetëvrasjeve në IEVP-të është një problematikë që duhet të marrë vëmendjen e duhur nga drejtoritë e burgjeve. Ne kemi evidentuar mungesë masash parandaluese, si dhe mungesë në organikën e personelit shëndetësor dhe social apo në infrastrukturën e amortizuar që kanë këto ndërtesa, të cilat janë jashtë standardeve të kërkuara.

Në lidhje me gjendjen, ne monitorojmë dhe vizitojmë vit për vit jo vetëm çdo burg, por edhe pjesën më të madhe të stacioneve të policisë. Cili është problemi kryesor? Problemi në stacionet e policisë ka të bëjë me situatën e gjendjes fizike në këto stacione policore. Pra, edhe nëse ka një rritje dhe ndjeshmëri më të lartë nga ana e stafit për zbatimin e të drejtave të njeriut, kushtet fizike në postat e policisë nuk janë në përputhje me ligjin e miratuar nga Kuvendi dhe me rregulloren e vetë policisë. Në këto kushte, pavarësisht rekomandimeve të vazhdueshme që ne kemi dhënë, përsëri në këto ambiente situata rezulton jo në përputhje me parashikimet ligjore.

Për herë të parë ne kemi përgatitur një tabelë përmbledhëse, ku kemi paraqitur ndryshimet sipas rekomandimeve që kemi bërë ndër vite për ta paraqitur në një tjetër mënyrë këtë problematikë. Pavarësisht vullnetit të shfave të komisariateve, ne mendojmë se

parandalimi domosdoshmërisht kërkon disa garanci strukturore, por është e pamundur që në të gjitha rajonet e policisë pyetja e personave të ndaluar apo të arrestuar të bëhet në dhomat e punonjësve. Pra, megjithëse ligji përcakton se duhet të ketë një dhomë të posaçme ku të pyeten këta persona dhe të garantohet monitorimi i tyre, kjo gjë nuk ka ndodhur, madje nuk ka ndodhur edhe aty ku këto dhoma ekzistojnë. Pra, edhe në ato pak rajone policie të rikonstruktura këto dhoma, të cilat janë bërë në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të rregullores së policisë, nuk përdoren. Kështu që në këtë pikë ne mendojmë se është neglizhuar lidhur me garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe të gjithë punonjësit e policisë e ndiejnë veten më mirë që t'i pyesin të ndaluarit apo të arrestuarit në dhomat e tyre, duke lënë mundësi, pavarësisht aprovimit apo jo, të ushtrimit të një presioni apo force më të madhe ndaj personave për marrjen e deklarimeve të tyre. Ne i kemi adresuar që të gjitha këto në parashikimet që kemi bërë edhe në komisariate të ndryshme.

Me të gjitha rekomandimet e shumë vjetëve të pranuar nga ana e Drejtorisë së Policisë apo nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, vazhdon të mbetet problem regjistrimi i rregullt i hyrjeve–daljeve apo mbajtja në rregull e regjistrave në rajonet e policisë. Çfarë sjell kjo? Jo domosdoshmërisht sjell dhunë në secilin prej rasteve, jo domosdoshmërisht sjell problem të hapur, por nuk u garanton qytetarëve të drejtat që ua ka njohur ligji.

Në gjykimin tonë, dokumentimi, përgatitja dhe hartimi i të gjitha këtyre procedurave është për të garantuar të drejtat e njeriut; për të garantuar që personat të mos mbahen më shumë se 10 orë të shoqëruar në polici; për të garantuar që ata të dalin para gjykatës brenda afatit të caktuar ligjor, i cili është i qartë në ligj, dhe jo për t'u anashkaluar dhe për t'u konsideruar si një garanci, e cila nuk ka ndonjë rëndësi, sepse herë pas here mund të bëhet edhe ndonjë gabim.

Në këto raste, pavarësisht se ka një vullnet të qartë të shefave të komisariateve, që duan ta zbatojnë rregulloren, sepse ata nuk kanë shprehur ndonjë vullnet kundër zbatimit të këtyre të drejtave, por duhet të themi se jo në pak raste ne kemi hasur probleme me regjistrat dhe i kemi adresuar në secilin prej rekomandimeve që kemi bërë.

Një rekomandim i përgjithshëm, për të cilin ne do të paraqesim shumë shpejt një raport të veçantë në Kuvend, është në lidhje me çështjen dhe problematikën e protestave dhe tubimeve për rastin e Kukësit. Kjo u është dërguar të gjitha organeve përkatëse në formën e një rekomandimi dhe, brenda muajit të ardhshëm, kjo do të vijë edhe te ju si një raport i veçantë me gjetjet përfundimtare. Këto janë problematikat për sa i përket çështjes së burgjeve. Gjithashtu, lidhur me çështjen e burgjeve dua të shtoj se ne kemi rekomanduar mbylljen e disa prej tyre, për shkak se janë në kushte çnjerëzore, pra futen në kuadrin atyre që konsiderohen kushte denigruese dhe çnjerëzore. Ministria e Drejtësisë e ka marrë në konsideratë raportimin

tonë të përsëritur dhe për dy nga këto burgje ka shpallur konservimin që në shtator të vitit të kaluar. Flasim për *post factum*, sepse raportimi është për të gjithë vitin e kaluar. Kjo do të thotë se në këto burgje nuk shkojnë persona të rinj. Burgu i Zaharisë, fatmirësisht, është drejt mbylljes. Kushtet në këtë burg janë vërtet të papranueshme për personat e sëmurë që ndodhen aty. Nga ana tjetër, kemi shprehur po të njëjtin qëndrim për burgjet e Sarandës, Tepelenës dhe Kukësit. Pra, këto burgje kanë nevojë për ndryshime thelbësore. Për burgun e Sarandës ne kemi kërkuar mbylljen e tij, por jo për dy të tjerat, sepse nuk mund të mbyllen gjysma e burgjeve në vend. Pra, çështja qëndron te nevoja për ndryshime thelbësore në këto burgje. Ndërkohë, janë adresuar edhe një sërë problematikash, të cilat ne i kemi ngritur në rekomandimet e mëparshme. Nga mënyra dhe forma e rekomandimeve, ne jemi munduar të tregohemi sa më analitikë. Tashmë, kur ne shkojmë në një inspektim, fillojmë punën, shikojmë se çfarë është bërë lidhur me rekomandimet e mëparshme dhe çfarë ka mbetur pa u bërë, duke u kërkuar personave dokumentacion për rastet në të cilat pretendohet apo mendohet se nuk kanë pasur buxhet dhe nuk kanë bërë asnjë përmirësim. Edhe për këto raste ne u kemi kërkuar drejtorëve të burgjeve dhe shefave të komisariateve të gjithë dokumentacionin shkresor, dhe ata ua kanë adresuar këtë problem titullarëve të tyre, sepse thoshin se nuk kishin buxhet dhe, më pas, kur vinin këtu thoshin se çështja e buxhetit ishte zgjidhur. Në fakt, ne tani jemi munduar që në çdo rast të shikohet nëse ata e kanë adresuar këtë problematikë. Këto kisha për sa u përket çështjeve të burgjeve dhe çështjeve të policisë në përgjithësi, sepse janë dy nga seksionet me volumen më të madh të punës në institucion.

Një problem tjetër, jo pak i rëndësishëm, vazhdon të mbetet numri i lartë i kërkesave të ardhura në institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me mungesën e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore civile dhe administrative. Moszbatimi në kohë i këtyre vendimeve vazhdon të mbetet një shqetësim për qytetarët, ndonëse ka një qëndrim të përgjithshëm për ta përmirësuar situatën. Gjithashtu, një problematikë tjetër ka të bëjë me mënyrën e veprimtarisë të punës së përmbauesve privatë për adresimin e këtyre problematikave. Ne kemi nxjerrë një numër të konsiderueshëm rekomandimesh për këtë çështje. Nëse ju do të keni pyetje specifike lidhur me këtë çështje, sigurisht unë mund ta adresoj këtë gjë në mënyrën më specifike.

Problem thelbësor mbetet edhe moszbatimi efektiv i ligjit “Për ndihmën juridike falas”. Ne e kemi mirëpritur ligjin e ri, sigurisht edhe buxhetin që Kuvendi me shumë përpjekje vendosi për herë të parë lidhur me këtë çështje. Nga ana tjetër, nuk mund të lë pa thënë se edhe ky ligj, ashtu si një sërë ligjesh të tjera, ka mbetur pa akte nënligjore zbatuese. Megjithatë ka kaluar më shumë se një vit e gjysmë këto akte nuk janë miratuar ende në mënyrë që ligji të bëhet efektiv. Nuk ka rëndësi vetëm miratimi i ligjeve për t’u njohur qytetarëve të drejtat e tyre,

në rastin konkret për dhënien e ndihmës juridike falas, nëse ato mbetet pa buxhet dhe pa akte nënligjore për t'i vënë në zbatim. Prandaj, megjithëse ligji është miratuar në vitin 2017, aktet nënligjore ende nuk kanë dalë. Kjo çështje është adresuar edhe nga ana e Kryetarit të Kuvendit, të cilin dua ta falënderoj për vëmendjen që i ka kushtuar kësaj çështjeje. Ai u ka kërkuar organeve të ekzekutivit që të zbatojnë afatet e përcaktuara në ligj për hyrjen në fuqi të akteve nënligjore, në mënyrë që ligji të bëhet efektiv. Kjo, në fakt, është puna dhe detyra e tyre, por mbetet një problem dhe një sfidë jo e vogël për shumë qytetarë, të cilët nuk kanë ku ta kërkojnë ndihmën juridike falas. Përgjigja që, herë pas here, duhet t'ua jap qytetarëve është se ka një numër shoqatash dhe organizatash, të cilat e ofrojnë këtë ndihmë, por kjo gjë është ende e pamundur, edhe pse ekziston një buxhet për ta dhënë në mënyrë të strukturuar ndihmën juridike falas për qytetarët.

E drejta e pronës është një tjetër problem thelbësor për vetë numrin e jashtëzakonshëm të ankesave që na kanë ardhur në lidhje me këtë çështje. Këto problematika janë në moskthimin përgjigjeve nga ana e Agjencisë për Trajtimin e Pronave. Tashmë, ka përfunduar edhe afatin i saj ligjor dhe nuk është zgjidhur ende problemi i pronave, por i ka adresuar në gjykatë. Brenda 3 vjetëve Agjencia mori vendime për një pjesë të kompensimeve dhe më pas të gjitha çështjet e tjera, pavarësisht numrit shumë të madh të kërkesave, nuk u trajtuan prej tyre brenda këtij afati. Ne këtë gjë e konsiderojmë shkelje thelbësore të të drejtave të qytetarëve, pasi afati 3-vjeçar, që kishte në dispozicion Agjencia, rezultoi infektiv.

Gjithashtu, probleme shumë të mëdha ka edhe në regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe në mënyrën se si trajtohen këto çështje nga ana e regjistruesve vendorë. Kjo, në fakt, nuk është një gjë e re, sepse ne e kemi parë edhe në medie, që mekanizmi tjetër i trajtimit të ankesave të qytetarëve, ai i bashkëqeverisjes, është duke e nxjerrë si problemin thelbësor në vend. Ne vazhdojmë të kemi përsëri probleme, pasi shumë drejtues të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk na kthejnë fare përgjigje. Me sa duket, ata mendojnë se mund ta adresojnë këtë çështje vetëm nëpërmjet bashkëqeverisjes. Ne e kemi ngritur zërin për gjë, kemi bërë edhe rekomandimet përkatëse për pushimin nga puna të këtyre personave, pasi realisht detyrimet kushtetuese për trajtimin e kërkesave të Avokatit të Popullit duhet të merren me përparësi.

Ne shpresojmë që reforma e re lidhur me ligjin e kadastrës të adresojë ndoshta një sërë prej këtyre problemeve, por përsëri mbetet për t'u parë zbatimi në praktikë i këtyre çështjeve.

Një shqetësim tjetër për institucionin e Avokatit të Popullit ka të bëjë me numrin e vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat kanë dalë për bllokimin e të drejtës, për pezullimin e regjistrimeve, për marrjen e titujve të pronësisë në zonën e bregdetit, por edhe për pezullimin

e përkohshëm të vijimit të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore. Pra, në gjykimin tonë, dy vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 138/2018 dhe nr. 708/2018, kanë pasur një problematikë jo të vogël nga pikëpamja e zbatimit të të drejtave të njeriut.

Së pari, sepse mosgarantimi apo pezullimi, qoftë edhe i përkohshëm, i të drejtës së regjistrimit apo marrjes së titujve të pronësisë për qytetarët është shkelje e të drejtave themelore për të poseduar pronën e tyre.

Së dyti, ne mendojmë se për shumë vjet duhej të ishte adresuar qartësisht prej tyre çështja e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ne nuk mund ta zgjidhim këtë gjë duke i ngarkuar më shumë qytetarët për ushtrimin e të drejtave të tyre.

Mosregjistrimi i pronave në bregdet ka qenë një problem shumë i madh, i cili nuk mund të konsiderohet si problem i qytetarëve. Pra, garancia që shteti u jep qytetarëve për të pasur një sistem regjistrimi të pasurive të paluajtshme është një detyrim i tyre dhe nuk është një detyrim i qytetarëve për të paraqitur dokumente pronësie pafundësisht tek organet e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në këtë kuadër, ne mendojmë se duhet të ketë një vëmendje më të madhe për të adresuar problematikat e qytetarëve. Pra, duhet të përfundojë regjistrimi dhe hedhja në sistem i të gjitha pronave, që qytetarët në mënyrë të lirshme të zbatojnë të drejtën e tyre të pronës që është kusht themelor për ta.

Ne kemi adresuar një sërë problematikash për të drejtën e arsimit...

Ulsi Manja – Zonja Ballanca, më falni që po ju ndërpres!

Këto janë të gjitha në raportin që ju keni paraqitur. Besoj se Shërbimet e Kuvendit ju kanë njohur me manualin e raportimit, i cili ka të bëjë me përmbushjen e rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit për institucionin që ju drejtoni për vitin 2018. Materiali i plotë është mbi tryezë dhe unë këtë gjë nuk e thashë për efekt të kohës, por sepse kolegët kanë shumë pyetje .

Erinda Ballanca – Unë jam dakord që ta përfundoj raportimin këtu.

Ulsi Manja - Mund ta përfundoni nëse jeni në fund.

Erinda Ballanca – Ne kemi përgatitur edhe një material të shkurtër të raportit sipas manualit, rreth 6 faqe, që është i gjithë raporti në mënyrë të përmbledhur dhe unë jam duke iu referuar atyre pikave.

Në lidhje me raportimin, unë iu përgjigja kërkesës suaj për të paraqitur në mënyrë të përmbledhur problemet e të drejtave të njeriut.

Ne, gjithashtu, kemi bërë një raportim për sa u përket çështjeve të rezolutës së Kuvendit.

Lidhur me çështjet e rezolutës së Kuvendit për vitin e kaluar, mund t'ju them se, fatmirësisht, ne e kemi plotësuar numrin e komisionereve. Kjo ka qenë detyra thelbësore që ne kemi pasur. Vërtet kemi pasur një problem, sepse nuk e kemi realizuar këtë detyrë brenda afatit kohor, që na kishte përcaktuar Kuvendi, por, efektivisht, ishte e pamundur ta realizonim për shkak të kandidaturave që duhej të paraqisnim. Unë sot jam shumë e kënaqur që kam një staf të plotësuar me 5 komisionere, ku, për hir të së vërtetës, nga ana e Kuvendit mund të konsiderohet si ekzemplar i diskriminimit pozitiv, pasi jemi që të gjitha femra. Unë ju falënderoj shumë për këtë fakt, sepse kjo ka qenë edhe kërkesa jonë e parë. Tani na takon neve që këtë besim, që ju na dhatë, t'ju shpërblejmë, duke treguar se institucioni ynë do të punojë më mirë për të drejtat e qytetarëve dhe individëve.

Për sa i përket rekomandimit tjetër të rezolutës së Kuvendit, i cili bën fjalë për forcimin e marrëdhënies me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mund të them se ky rekomandim është plotësuar. Në fakt, ne kemi një raport kundër diskriminimit, i cili është i shkëlqyer dhe jemi në përfundim të një marrëveshjeje me Komisionerin për zyrat rajonale. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka disa zyra rajonale dhe marrëveshja jonë ka të bëjë që këto zyra të përdoren edhe nga institucioni ynë. Gjithashtu, Komisioneri do të përdorë zyrat tona aty, ku ai nuk ka përfaqësues. Gjithashtu, ne kemi adresuar në Kuvend edhe një problem shqetësues në lidhje me forcimin e këtyre zyrave rajonale, sepse qeveria vendore nuk e shikon si prioritet zbatimin e ligjit për sa i përket kësaj çështjeje. Pra, ata e kanë detyrë ligjore që të na ofrojnë një zyrë, por kjo nuk realizohet prej tyre, ndaj këtë shqetësim të vazhdueshëm në lidhje me këtë çështje ne ia kemi adresuar Kuvendit.

Një rekomandim tjetër në rezolutën Kuvendit ishte se ne duhej të krijojmë një mekanizëm efektiv për ndjekjen dhe zbatimin e çështjeve. Ne kemi krijuar një sistem elektronik për menaxhimin e rasteve, i cili nuk është një sistem bashkëkohor, sepse për këtë na duhej buxhet. Ne nuk kemi pasur buxhet për këtë gjë, ndaj investimet tona kanë qenë shumë të vogla për këtë çështje. Ne e kemi të pamundur që ta adresojmë në mënyrë të qartë, megjithatë kemi paraqitur kërkesa të disa donatorëve për të mundësuar bërjen e një sistemi të ri, që të jetë më efektiv për menaxhimin e rasteve.

Rekomandimit tjetër i rezolutës ishte që ne të vazhdonim kontributin tonë për reformën në drejtësi dhe unë këtë çështje e adresova. Ne jemi institucioni i vetëm, i cili pa asnjë buxhet shtesë ka plotësuar çdo detyrë që i është lënë. Nuk kanë qenë të pakta detyrat e lëna nga Kuvendi, në kuptim të ligjit për reformën në drejtësi, dhe vazhdojmë me dedikim ta bëjmë një gjë të tillë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit zonja avokate!

Unë do t'ia kaloj fjalën relatorit, zotit Braho për një konstatim të shkurtët të gjetjeve të raportit të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018. Më pas do të vazhdojmë me pyetjet nga kolegët.

Spartak Braho – Faleminderit, zonja Avokate e Popullit!

Unë do të evidentoj faktin se institucioni juaj para pak ditësh ka mbushur 20 vjet të punës së tij, por ndoshta ju nuk e dini se jeni e re dhe në atë kohë, kur është krijuar, jeni marrë me gjëra të tjera, por më 4 shkurt institucioni i Avokatit të Popullit ka mbushur 20 vjet. Kjo vlen të kujtohet, sepse zoti Emir Dobjani, i cili ka filluar punën i pari si Avokat i Popullit, nuk ka arritur kurrë që të paraqesë një raport me 100 faqe.

Raporti juaj është i plotë (mendoj se është pak i gjatë për t'u lexuar), dhe ju keni bërë një analizë që i plotëson të gjitha kushtet, në mënyrë që ky komision të njihet me aktivitetin e institucionit, që ju drejtoni, dhe të nxjerrë përfundime.

Unë nuk po ndalem te kuadri ligjor që detyron institucionin tuaj të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë do të ndalem shkurtimisht te ndonjë vërejtje që ia vlen të evidentohet, për shembull, në raport nuk shfaqet qartë plotësimi i kërkesave të rezolutës për buxhetimin gjinor dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Është e nevojshme që ky rekomandim të vlerësohet me prioritet dhe të përmbushet brenda vitit 2019.

Së dyti, lidhur me natyrën juridike të 2915 ankesave, që janë konsideruar si këshillime për qytetarët, në raport duhet të saktësohet nëse janë ankesa jashtë juridiksionit dhe kompetencës apo janë të ndikuara për të na dhënë perceptimin e publikut lidhur me rolin dhe misionin e Avokatit të Popullit. Pra, nuk del qartë në raport numri i çështjeve të filluara kryesisht nga Avokati i Popullit, nga totali i çështjeve që janë trajtuar në vitin 2018.

Së treti, konstatohet se në faqen zyrtare të institucionit 51 raportet e inspektimit dhe të rekomandimit, nuk janë të aksesueshme, gjë që e vështirëson njohjen nga publiku dhe nga palët e treta të interesuara rreth konkluzioneve të arritura nga ky institucion. Pavarësisht kësaj, në një numër të vogël rastesh janë realizuar njoftime në formë lajmi ose në mënyra të tjera.

Unë shprehem pozitivisht për aktivitetin e institucionit, megjithatë nisur nga analiza e statistikave për vitin 2018 më rezulton se ka një ulje të numrit të rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucioni i administratës publike, por ka rritje të përqindjes të rekomandimeve të zbatuara, ndërkohë që edhe në lidhje me rekomandimet pa përgjigje rezulton se në vitin 2018 janë pak rekomandime pa përgjigje krahasuar me vitin 2017. Kjo është një çështje ose tregues pozitiv që duhet të vazhdojë të ecë në këtë rrugë.

Çështja e parafundit lidhet me të drejtën e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Ky është shqetësim, i cili është paraqitur nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe pa dyshim që është një çështje që duhet të sensibilizojë institucionin tuaj.

Lidhur me rekomandimet për vitin 2019 do të theksoja 4 çështje:

Së pari, Avokati i Popullit duhet të vazhdojë të ketë në vëmendje gjatë vitit 2019 minimizimin e ankesave, të cilat janë jashtë sferës së veprimit të tij;

Së dyti, Avokati i Popullit duhet të rrisë angazhimin e tij publik në mbrojtje të interesave të shtetasve edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si edhe njësité ekstraterritoriale ku zbatohet legjislacioni shqiptar;

Së treti, Avokati i Popullit duhet të bëjë publikimin e tij në faqen zyrtare të rekomandimeve dhe çështjeve të zgjidhura në funksion të transparencës dhe informimit duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale;

Së fundi, Avokati i Popullit duhet të dijë të vijojë ndjekjen rast pas rasti të çështjeve që lidhen me rekomandimet e refuzuara, por të papërbushura, sipas procedurës së nenit 23 të ligjit nr. 8454 të vitit 1999.

Gjithashtu, Avokati i Popullit duhet të rrisë angazhimet në ndjekjen dhe përbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, duhet të përbushë axhendën e vitit 2030 me fokus të veçantë buxhetimin gjinor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të konsumatorëve, detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi për fushat përkatëse ose rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Shtohet një çështje lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore për hyrjen në fuqi ose zbatimin e ligjit për ndihmën juridike falas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga kush e kërkon këtë? Ky është detyrim që duhet ta bëjë Ministria e Drejtësisë, prandaj bëjeni objekt dhe bëni zhurmë që ajo të nxjerrë sa më parë aktet nënligjore. Kjo është drejta juaj, është edhe e drejta e Kuvendit të Shqipërisë të bëjë kontrollin parlamentar që ushtron për nxjerrjen e akteve nënligjore. Me këtë rast unë do t'ju sugjeroja ta zgjidhni përfundimisht çështjen.

Duke mbyllur relatimin tim unë e vlerësoj punën tuaj me nota pozitive.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Braho!

Kur të merrni fjalën për t'u dhënë përgjigje kolegëve, mund të adresoni edhe përgjigjen për zotin Braho.

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi për pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Më vjen mirë që vlerësoni faktin se Kuvendi ka bërë një zgjedhje të mirë. Gjithashtu, fakti që sot ju në raport adresoni një sërë problematikash në mënyrë më analitike se viti i kaluar tregon se zgjedhja që ne kemi bërë për komisionerët dhe angazhimi i tyre ka dhënë produktin e vet.

Unë kam shumë pyetje, por do të ndalem në disa prej tyre duke ruajtur të drejtën që në cilësinë e nënkryetares dhe të kryetares së Komisionit të të Drejtave të Njeriut të bëj disa takime dhe pasi të bëjmë edhe monitorimet në vend, të ballafaqohemi për disa çështje për të cilat konstatoj se ka gjetje dhe konkluzione të ndryshme nga ato që ka thënë ministrja e Drejtësisë, për të cilat kanë raportuar institucionet e tjera ose i keni adresuar në raportin që ju keni adresuar për shqetësimet të veçanta. Unë kam një sërë pyetjesh nga institucionet për rekomandimet që ju keni bërë.

Po e filloj me pyetjen e parë që lidhet me monitorimin që i keni bërë Kuvendit të Shqipërisë. Në raport për herë të parë jepen vlerësime për punën që bën Kuvendi i Shqipërisë si mekanizëm ndërinstitutional, çfarë duhet të bëjë më mirë Kuvendi e të tjera. Konkretisht, në një nga konstatimet thoni që numri i rekomandimeve të pranuar është më i ulët në raport me vitin 2017, por vetëm kaq thuhet në raport, nuk thuhet cila është natyra e rekomandimeve të pranuar, cilat janë institucionet që nuk e kanë pranuar dhe a janë adresuar ato në Kuvendin e Shqipërisë në kohën e duhur për të marrë vëmendje nga Kuvendi.

Pyetja e dytë është për rekomandimin që bëni për mekanizmin ndërinstitutional në faqen 12 të raportit, ku thoni se ky mekanizëm ka vend për përmirësime. Në ç’drejtim?

Pyetja e tretë ka të bëjë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ka qenë një rekomandim i Kuvendit për rritjen e angazhimit tuaj në mundësinë e ndjekjes së zbatimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Të them të drejtën më bën përshtypje që ne ju rekomandojmë juve dhe ju na rekomandoni ne dhe na thoni që Kuvendi duhet të punojë më mirë me qeverinë për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Cili ka qenë rekomandimi i Avokatit të Popullit në zbatimin e rekomandimit që ka bërë Kuvendi për t’u angazhuar në monitorimin e objektivave për të adresuar në qeveri dhe Kuvend nevojat për ndryshime ligjore? Kuvendi nuk ka nga ta marrë vesh nëse një institucion i pavarur nuk i adreson ato. Së pari. Së dyti, çfarë doni të thoni me shprehjen “roli i Kuvendit mund të jetë efektiv për të përdorur mjetet dhe mundësitë e parlamentarëve për të përdorur në mënyrë efektive ligjet dhe buxhetet”? A jeni në dijeni ju që ne kemi një plan veprimi, kemi koordinator në çdo komision, kemi nga një koordinator që adreson këto shqetësime dhe në emër të Kuvendit kemi një zonjë ish-drejtoreshë e INSTAT-it, deputeten Milva Ekonomi, dhe që ky mekanizëm koordinorësh bën mbledhje sistematike? Si e keni monitoruar këtë proces që keni arritur në atë konkluzion?

Pyetja tjetër ka të bëjë me neglizhencën e pajustificuar nga ana e organeve gjyqësore, lidhur me zbatimin e detyrimit ligjor për njoftimin e detyruar. Ju thoni që gjykatat nuk bëjnë njoftimin e vendimeve brenda afatit 1-vjeçar. A keni adresuar ndonjë rekomandim për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë? Nëse keni adresuar, cili është reagimi?

Gjithashtu, ju keni adresuar një shqetësim tjetër lidhur me përmbaruesit gjyqësorë dhe ndajmë të njëjtin mendim që niveli i përmbaruesve ka qenë ai që ju përshkruani në raport. Kjo është arsyeja që ne kemi miratuar një ligj të ri me standarde europiane. Por pyetja ime është: sa herë i keni adresuar rekomandime ministrit të Drejtësisë për të filluar procedimet disiplinore ose sa herë i jeni adresuar Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve dhe cilat janë qëndrimet e tyre?

Gjithashtu, ju adresoni në raport një çështje që lidhet me të drejtat e fëmijëve. Në fakt, e prisja që, meqenëse kemi një komisioner të posaçëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve këto çështje dhe të drejtat e fëmijëve të ishin adresuar në mënyrë më të detajuar dhe konkrete. Duke qenë se nga raporti që unë kam para nuk arrij të kuptoj problematikat që ju keni konstatuar, por edhe angazhimin tuaj, unë kam disa pyetje. Ju jeni 7 komisionerë, secili të mbajë shënim pyetjet e veta. Ju thoni në raport që të drejtat e fëmijëve zënë 1/3 e çështjeve të trajtuara nga Avokati i popullit. Si ju kanë aksesuar fëmijët ju që keni adresuar këto problematika? A janë fëmijët që kanë akses në platformën tuaj, apo raporti bazohet në raportet e organizatave të shoqërisë civile? Cilat janë rekomandimet që ju keni adresuar lidhur me zbatimin e strategjisë së drejtësisë penale për të mitur? A janë marrë ata në konsideratë?

Lidhur me situatën e fëmijëve në institucionet e kujdesit shoqëror, cilat janë rekomandimet që ju keni adresuar dhe çfarë ndikimi kanë pasur këto rekomandime në përmirësimin e trajtimit të fëmijëve?

Gjithashtu, kam një pyetje tjetër lidhur me një nga detyrimet që institucioni juaj ka në kuadër të konkluzioneve që ka bërë komiteti i SIDOS në vitin 2016 kur i ka kërkuar Avokatit të Popullit të bëjë rekomandime të përshtatshme për çështjet e të drejtave të grave. A ka pasur rekomandime nga ana e institucionit tuaj lidhur me këtë çështje dhe si është zbatuar ky rekomandim?

Gjithashtu, kam një pyetje, sikurse edhe relatori, deputeti Braho, lidhur me buxhetimin afatmesëm të institucionit të Avokatit të Popullit dhe adresimin e çështjeve me ndjeshmëri gjinore. Nuk shohim në këtë dokument që ju keni indikatorët e ndjeshmërisë gjinore përparësi në veprimtarinë tuaj. Cila është arsyeja që nuk e keni adresuar këtë aspekt në veprimtarinë tuaj?

Së fundi, kam ndjekur me vëmendje punën e zyrave vendore dhe kemi pasur korrespondencë me prefektët në Këshillin e Ministrave dhe me ju. E kuptoj shqetësimin tuaj që organet e pushtetit vendor duhet të krijojnë zyra të përshtatshme për ju, por të mos harrojmë se me ligjin e qeverisjes vendore organeve të pushtetit vendor iu kemi kërkuar zyra për mekanizmin e parandalimit të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave për fëmijët, për shërbimin e provës, për ndihmën juridike dhe komisionerin për të drejtën e informimit. Nga raporti më rezulton se në përgjithësi keni një gjetje pozitive në disa bashki, problemi qëndron në Berat dhe Sarandë dhe Pogradec, ku zyrat nuk janë në vendin e përshtatshëm. Si angazhohen përfaqësuesit e zyrave tuaja për të qenë pranë njerëzve për ankesat dhe sugjerimet që ata kanë?

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit!

Unë mendoj që të mblidhen të gjitha pyetjet dhe pastaj t'ua kalojmë fjalën Avokates së Popullit dhe komisionerëve respektivë që të përgjigjen.

Elena Xhina-Faleminderit!

Një pjesë e pyetjeve u ezauruan nga zonja Hysi. Unë do të doja të dija sa është numri i çështjeve të nisura kryesisht nga vetë Avokati i Popullit.

Në rezolutën e vitit të kaluar ne kemi vënë si detyrë investimin e Avokatit të Popullit për kryerjen e një studimi në lidhje me mbipopullimin e burgjeve. A është bërë ky studim nga ana juaj? Në krahasim me vitin 2017 si është mbipopullimi i burgjeve?

Lidhur me ankesat e bëra nga të burgosurit dhe familjarët e tyre pretendohet për ushtrim të dhunës fizike, psikologjike dhe keqtrajtim. Sa raste janë referuar në prokurori nga ana juaj dhe a janë gjetur me vend këto pretendime?

Ulsi Manja – Po, zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Zonja Ballanca unë kam tri pyetje që për situatën janë shumë sensitive. A keni një konstatim tuajin ose një raport tuajin ose të komisionerëve të tu për shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë arrestimeve të fundit gjatë mbajtjes në burg të protestuesve të ditëve të fundit dhe a ka ndonjë rast flagrant të konfliktit të interesit të gjyqtarëve që kanë mbajtur në burg këta protestues? E para.

Së dyti. A ka një raport nga ju ose nga komisionrët tuaj se si është zbatuar protokollin i hedhjes së gazit lotsjellës ndaj protestuesve ditë pas dite, një raport konkret sa i takon masës, sasisë, mënyrës së hedhjes, minutat nga njëra-tjera, apo jo?

Së treti, unë kam qenë në shtëpi kur kam parë në televizion një shfaqje të turpshme, ku Avokati i Popullit, pra ju, nuk lejoheshit nga ana e policisë të hynit dhe të vizitonit në spital

të plagosurit apo të dëmtuarit gjatë një proteste të opozitës. Kjo është një shfaqje shumë e rëndë për ata që e shohin, sepse këtu nuk jemi në një shtet policor, por jemi në një shtet që ndodhet në mes të Europës. A ka një raport konkret, një kërkesë apo masa të tjera që këto skena të turpshme të mos shfaqen më?

Unë vetë kam profesionin e avokatit dhe deri para se të vija këtu e kam ushtruar këtë profesion, prandaj e di shumë mirë që avokati lejohet të hyjë dhe ta vizitojë në çdo moment të përfaqësuarin e tij dhe jo përfaqësuesi i një institucioni kushtetues të ndalohej nga një polic, duke i thënë se kishte urdhër për të mos e lejuar të futet brenda. Këto janë pyetjet që kisha.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Përmeti!

Kush ka pyetje të tjera?

Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Unë kam një pyetje, por në të njëjtën kohë kam edhe një vërejtje për Avokaten e Popullit. Emri i Avokatit të Popullit është gjithëpërfshirës dhe në këtë mënyrë zonja Ballanca ka marrë votëbesimin e Kuvendit të Shqipërisë si nga opozita dhe nga maxhoranca, për ta marrë këtë pozicion, por në daljet e shpeshta të zonjës Ballanca shoh se pozicionohet në mënyrë të njëanshme, konkretisht kundër shtetit. Jam dakord që shteti duhet të zbatojë ligjit dhe të respektojë të drejtat e njeriut, mirëpo te pozicionimi i zonjës Ballanca, duke marrë shkas edhe nga pyetjet që ngriti zoti Përmeti, sidomos në daljen e fundit në media, shihja një interesim të saj për të plagosurin, zotin Dollapi. Më bëri përshtypje, jo vetëm mua, por edhe qytetarëve që na kanë shkruar, mosinteresi nga ana e saj në media për policët, sepse ishin 15 policë të plagosur. Ky lloj pozicioni nuk ju përfaqëson as ju dhe as emrin e madh që keni, Avokat i Popullit,

Ulsi Manja – Cila është pyetja juaj zoti Leka?

(Diskutime pa mikrofon)

Edmond Leka – Pyetja ime është se pse është pozicionuar në mënyrë të njëanshme Avokati i Popullit?

Ulsi Manja – Kush ka pyetje të tjera?

Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke marrë shkas nga parafolësi, dua të them se ne jemi njerëz politikë dhe normal që do të bëjmë edhe politikë, por kur flitet për qytetarët besoj se prevalon interesi i qytetarëve mbi të tjerët. Ne i mbështesim ruajtësit e rendit, sepse edhe ata janë qytetarë, por besoj se Avokatja e Popullit në radhë të parë duhet të ushtrojë ligjshmërinë e saj për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve që protestojnë. Unë nuk mendoj se është e vërtetë që Avokatja e Popullit ka shkruar

dhe është interesuar vetëm për të një qytetar në atë rast, por veprimet e momentit ndaj qytetarit ishin më se flagrante dhe të dukshme.

Unë kam disa pyetje sa i takon raportit të Avokatit të Popullit, i cili për mua deri diku ishte shterues. Ju cituat në raportin tuaj rastin e Kukësit. A mund të na thoni se cilat janë masat e marra sa i takon këtij rasti flagrant të abuzimit të rolit të punonjësit të policisë ndaj shkeljes së të drejtave themelore të qytetarëve, në këtë rast të qytetarëve kuksianë?

Kohët e fundit vendi është përfshirë nga protesta të ndryshme politike, por edhe studentore, siç ishte rasti i dhjetorit. A keni ju si institucion ndonjë informacion nëse është ushtruar dhunë ndaj studentëve? Ne kemi parë se nuk është ushtruar dhunë fizike ndaj studentëve, por dhuna në vetvete, sepse ka edhe dhunë intimiduese, vjen nga faktorë të ndryshëm, e cila është jo e dukshme.

Ulsi Manja – A ka ndonjë pyetje të tjera nga kolegët?

Nuk ka pyetje të tjera nga kolegët.

Meqenëse jemi në fazën e pyetjeve edhe kam pyetjet e mia, për të cilat do të marr përgjigje kur të më vijë radha, sipas përgjigjeve të pyetjeve, duke filluar nga pyetjet e koleges Hysi deri te pyetjet e fundit të zotit Zeneli, ne mund të organizojmë edhe një seancë të dytë për përgjigjet e pyetjeve zoti Shameti, por e rëndësishme është që Kuvendi dhe Komisioni i Ligjeve ta ushtrojnë siç duhet funksionin e kontrollit parlamentar, sepse institucioni që ju drejtoni e ka emrin Avokati i Popullit dhe popull në fund të ditës jemi edhe unë edhe ti.

Unë do t'i përmbahem deri diku përmbushjes së rezolutës të Kuvendit për vitin 2018, por nga gjetjet e raportit dhe në anekset që i janë bashkëngjitur këtij raporti pyetja e parë, zonja avokate, ka të bëjë me nivelin e raporteve të bashkëpunimit institucional që ju keni me institucionet nën monitorim, pasi roli juaj është monitorim, konstatim, rekomandim dhe adresim, zgjidhje e problemeve.

Pyetja e parë: në çfarë nivelesh institucionale e keni bashkëpunimin me institucionet nën monitorim? Në anekset që ju i keni bashkëngjitur raportit flitet pothuajse për të gjitha institucionet e shtetit, pra janë shumë.

Pyetja e dytë, ka të bëjë me inspektimet apo monitorimet që ju bëni në ambientet e sigurisë në agjencitë e zbatimit të ligjit, e kam konkretisht për drejtoritë vendore të policisë dhe komisariatet. Sa herë keni qenë prezente ju, kur them ju, e kam fjalën për komisionerët, ndihmëskomisionerët apo stafi që ju drejtoni, në ambientet e drejtorive vendore të policisë dhe të komisariateve dhe çfarë problematikash keni konstatuar, çfarë keni sugjeruar dhe cilat kanë qenë zgjidhjet që janë gjetur për këto problematika?

Pyetja tjetër ka të bëjë me atë që tha zoti Leka. A prisni popull në institucionin që ju drejtoni, i cili vjen për ankesa apo për problematika të caktuara në raport me institucionet? Sa takime janë realizuar për vitin 2018, gjithmonë flas për takime të dokumentuara, jo për qytetarë që vijnë te dera e institucionit lënë aty një letër dhe ikin, por takime të dokumentuara dhe të materializuara që ju keni me qytetarët? Sa takime bëjnë komisionerët, ndihmëskomisionerët sipas fushave dhe ankesave me qytetarë të zakonshëm? Ju, vetë si Avokate e Popullit, sepse në raportin që ju na paraqitët nuk e pashë, a keni një shifër sa qytetarë prisni në ditë nga dita e hënë në të premte, apo në ditët kur keni takim përtej formave moderne të komunikimit si posta elektronike apo letrat e drejtpërdrejta që ju vijnë nga qytetarët?

Në fakt, jam shumë i lumtur dhe nuk kam arsye pse ta fsheh ndjenjën e krenarisë së bashku me kolegët e mi, ku për herë të parë Avokati i Popullit ka tamam atë fytyrë që duhet të ketë një institucion në kuptimin e përfaqësimit. Ne kemi pesë komisionere zonja, të cilat janë shumë profesioniste dhe të nderuara në profesionin e tyre, prandaj jam i bindur që me këtë standard Shqipëria është pararojë në rajon, gjithmonë për ato shtete që e kanë institucionin e Avokatit të Popullit, por edhe në Europë.

Një nga garancitë që unë kam se institucioni do ta luajë siç duhet rolin e tij është pikërisht garancia që më japin zonjat që janë në këtë institucion. Përtej kësaj, ju keni një staf me ato burimet njerëzore dhe buxhetin që keni në dispozicion, ku edhe ne kemi pjesën tonë të përgjegjësisë, më interesojnë politikat e motivimit të stafit. A ka institucioni i Avokatit të Popullit politika për ta motivuar stafin, sepse institucioni që ju drejtoni është një institucion moral, sepse ju, në fund të fundit, rekomandime bëni dhe niveli i përmbushjes dhe i zbatimit të rekomandimeve lidhet shumë me motivimin, autoritetin dhe dinjitetin e stafit. A keni menduar që t'i bëni pjesë së punës suaj në të ardhmen format se si mund të motivohet më mirë stafi për ta bërë si duhet detyrën dhe rolin që ju ka ngarkuar ligji?

Këto ishin pyetjet që unë kisha. Sa u takon përgjigjeve, meqë pyetjet janë të shumta, do t'ju sugjeroja që ju të jepni përgjigje për ato pyetje që ju takojnë si Avokate e Popullit, ndërsa pjesën tjetër mund ta marrë stafi, sipas përgjegjësisë së kanë, por do t'ju lutesha që përgjigjet të jenë sa më të sakta.

Zoti Zeneli, ka një pyetje të fundit.

Alban Zeneli – Jam dakord me kryetarin vetëm sa i takon pjesës që performanca juaj dhe e zonjave që janë në këtë institucion është shumë e mirëpritur, por nuk jam dakord me feminizmin e tepruar, që po trumbetohet shumë në këtë komision. Unë mendoj se një lloj barazie mes jush do të ishte mirë, në mënyrë që edhe ai maksimizimi i tepërt yni të mos shuhej.

Meqë e mora fjalën për pyetje doja të dija, sepse në raportin tuaj shterues keni sjellë edhe një tabelë të statistikave për dhomat e sigurisë të intervistimit nëpër komisaritet e policisë. Ju thoni se në të gjithë Shqipërinë janë 19 komisariate që i kanë këto dhoma në bazë të të gjitha standardeve, ku të përdorura në mënyrë efektive janë 17 dhe të kompletuara sipas të gjitha standardeve janë 8. A mund të na thoni se cila është arsyeja që nuk janë plotësuar të gjitha komisaritet?

Unë nuk besoj se në gjithë Shqipërinë janë 19 komisariate, prandaj doja të dija nëse ju e shihni këtë si një shkelje të rëndë të të drejtave, sepse unë mendoj se këto dhoma nuk janë brenda komisariateve, kështu që punonjësit e këtyre komisariateve i marrin qytetarët e ndaluar totalisht në shkelje të të drejtave të tyre.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli!

Zonja avokate, fjala është për ju, për përgjigjet e pyetjeve, duke filluar nga pyetjet e koleges Hysi.

Erinda Ballanca – Ju falënderoj që e keni lexuar me kaq vëmendje raportin e Avokatit të Popullit!

Unë jam shumë e kënaqur, sepse shqetësimi ynë kryesor është nëse ka apo jo vëmendje ndaj gjërave që ne themi dhe e gjitha kjo tregon që ka një vëmendje të jashtëzakonshme nga ana e Komisionit të Ligjeve për punën që ne kemi kryer gjatë vitit të kaluar. Një sërë prej problemeve që u ngritën janë probleme që adresojnë çështjet e vitit 2019 dhe ndoshta, kërkoj falje, pasi në raport ka problematika, të cilat mbyllen me vitin 2018 për efekt të raportimit vjetor, por unë mund t'ju përgjigjem edhe për çështjet e tjera.

Gjatë vitit që shkoi ne kemi marrë 188 raste me iniciativë. Pra, është një numër jo i vogël rastesh dhe nga numri total ne kemi 188 raste me iniciativë. Rastet me iniciativë, për t'ju sqaruar edhe juve, janë raste që në kuptim të ligjit ngrihen nga ana jonë pa vullnetin e qytetarit. Kjo është një kompetencë që Avokati i Popullit e ka, pra jo çdo ombusman apo jo çdo avokat i popullit nëpër botë e ka, por është një kompetencë që e kemi ne, të cilën e kemi përdorur duke marrë shkas nga botimet nëpër media, lajmet dhe njoftimet që na vijnë, sepse ky është burimi i informacionit, për të cilin ne e nisim vetë rastin me iniciativë. Aty ka një kufizim, ne mund të nisim një rast me iniciativë në rast se ai i përket të drejtave të personave të pamundur siç janë fëmijët apo personat e tjerë, të cilët nuk mund ta shprehin vetëm vullnetin e tyre ose është një rast, i cili mund të kenë ndikim në një kategori të gjerë personash.

Ne nuk mund të vazhdojmë dhe të hetojmë apo të marrim një rast me iniciativë nëse kemi kufizim ligjor. Sa u takon rasteve, për të cilat personi nuk do që rasti i tij të ndiqet, pavarësisht se ne mund ta nisim pa konsensusin e personit, nuk mund ta ndjekim atë rast, por

përrjashtim ka vetëm në ato raste kur ne mendojmë se çështja i përket zbatimit të të drejtave në mënyrë tërthore.

Një problem tjetër që ne kemi për një numër të madh të çështjeve që mund të nisim është fakti se çfarë ndodh me hetimet tona në rast se çështjet i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor apo prokurorisë. Ky është një problem tjetër që ne kemi hasur dhe për të cilin kemi pasur diskutime të shumta edhe si institucion. Nëse ne do ta zbatonim në mënyrë korrekte ligjin, atëherë qytetarët problemet dhe hallet e tyre do t'i zgjidhnin në gjykatë dhe jo tek Avokati i Popullit. Ne mund të bëjmë thjesht një rekomandim, por fakti që çështja shkon në gjykatë na ngushton ndonjëherë në paraqitjen e rekomandimeve, të cilat mbeten gjithmonë nga pikëpamja e të drejtave të njeriut dhe jo për zgjidhjen e çështjes në themel, ndërkohë që qytetarët kërkojnë zgjidhjen e çështjes në themel.

Këto kanë qenë disa prej shqetësimeve që ne kemi ndier dhe këto përbëjnë atë numrin që sapo ju thashë, ku një pjesë e madhe e këtyre çështjeve janë jashtë juridiksionit dhe kompetencave tona dhe ne nuk mund t'u japim zgjidhje. Sigurisht, ne mund të japim një rekomandim për një rast konkret, por nuk mund të zgjidhim çështje që janë për në gjykatë. Ne i kemi këshilluar qytetarët, sigurisht për ne është e rëndësishme që në zyrat tona rajonale dhe në zyrën qendrore ka një zyrë të hapur në të cilën priten qytetarët dhe aty ka juristë që i presin këta qytetarë, duke u dhënë këshillime, por në këtë zyrë janë edhe komisionerë për çështje përkatëse.

Pra, ne kemi zyra fizike të pritjes së publikut, që vjen dhe kërkon informacione dhe trajtojmë problematika të ndryshme, ku komisionerët e institucionit tonë sqarojnë probleme nga më të ndryshmet që njerëzit mund të kenë.

Sa i takon problematikës që u gjet në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, ne kemi pasur një faqe që ka qenë në një model jo bashkëkohor dhe gjatë vitit të kaluar ne kemi përgatitur faqen e re të Avokatit të Popullit, e cila është një faqe interaktive dhe në mënyrë të veçantë trajtohen problematika, sipas secilit seksion. Secili prej komisionerëve, në mënyrë që të rritet edhe roli i tyre, i paraqet ato në mënyrë interaktive, si dhe aktivitet që i përkasin secilit prej seksioneve. Kjo faqe ende nuk është në performancës e saj më të mirë, pasi ende po bëhen hedhjet që janë mbartur prej vitesh, sepse ne kemi pasur jo pak probleme edhe me AKSHI-n lidhur me rënien e faqes dhe probleme të tjera, por jemi duke e adresuar dhe duke e trajtuar këtë problem në mënyrë që të tëra rekomandimet tona të jenë të publikuara në faqe, siç janë problematikat e rëndësishme që kanë të bëjnë me iniciativat dhe të drejtat e njeriut, si dhe raste të tjera individuale.

Ne kemi pasur një problem programimi, të cilin jemi duke e adresuar në mënyrë që të jemi sa më bashkëkohorë dhe për këtë arsye faqen e kemi edhe në gjuhën angleze, por nuk kemi mjaftueshëm buxhet dhe njerëz për të bërë përkthimet e materialeve në gjuhën angleze. Kodimi apo programimi është i tillë që, nëse nuk del edhe në gjuhën angleze, është shumë e vështirë të bëhet paraqitja e informacionit në gjuhën shqipe. Pra, për këto arsye jemi duke bërë një rishikim të faqes, por këto janë probleme që i kemi adresuar dhe jemi duke i verifikuar edhe vetë si institucion.

Për problemet që u trajtuan, apo çështje që u ngritën me ESDG-të. Në fakt, institucioni i Avokatit të Popullit i ka dhënë ESDG-ve besoj vlerën më të madhe që mund t'u jepte. Konferencat tona vjetore janë konferenca që kanë trajtuar problemet e ESDG-ve apo çështjet e tyre (ne kemi për detyrim për të bërë një konferencë vjetore).

Nga ana tjetër, për të monitoruar zbatimin efektiv të masave nga secili organ për ecjen përpara në ESDG-të, duhet të dimë se ku jemi me to. Mbledhja e të dhënave është një gjë që nuk e bëjmë ne, sepse ne nuk kemi buxhet dhe as kapacitet për ta bërë këtë, ndaj e kemi trajtuar në raport duke e konsideruar si një shqetësim që ka dalë, të cilin gjykojmë se duhet të bashkohemi të gjithë për ta adresuar. Nuk është çështje e pjesës së rekomandimeve se kush e ka për ta bërë, ne apo ata, por ne mendojmë se duhet ta bëjmë të gjithë bashkë.

Institucioni i Avokatit të Popullit bashkë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara ka luajtur një rol thelbësor në pasjen në vëmendjen e vetë edhe trajtimin e ESDG-ve dhe në bërjen e tyre si një gur kilometrik. Pra, nëse themi qoftë për efekt të të drejtave të njeriut, qoftë për efekt të zhdukjes së varfërisë, apo për të mos lënë askënd mbrapa, mendoj se jemi ndër institucionet pararojë në kuptimin e çdo ESDG-je dhe si t'i bëjmë pjesë të jetës sonë për ta çuar çështjen përpara, jo vetëm në nivelin institucional brenda Shqipërisë, por edhe në nivel rajonal.

Në kuadër të organizatës së institucioneve të të Drejtave të Njeriut Europiane, ESDG-ja është një nga çështjet e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, e cila trajtohet me prioritet dhe ne po mundohemi ta trajtojmë edhe në nivel rajonal. Kontributi që kemi dhënë është vlerësuar maksimalisht nga këto institucione. Pa diskutim që mund të japim kontribut më të madh. Në disa fjalime që kam mbajtur në nivel ndërkombëtar kam trajtuar çështjen që shteti shqiptar është një nga shtetet që ka përqafuar edhe nëpërmjet rezolutës përkatëse zbatimin e ESDG-ve me veprime konkrete më mirë se shumë vende të tjera. Ndërkohë, do të na duhet që në punën e përditshme të secilit prej nesh ta kemi mjet, dhe kjo do të thotë në punën e çdo institucioni shtetëror, punën e ministrive dhe në pushtetin vendor, që është problemi kryesor.

Këtu vijmë në bashkërendim me diskutimin që bëmë në lidhje me zyrat rajonale. E vlerësoj dhe e kam vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm në këtë mbledhje ndihmesën

që është munduar të na japë Komisioni i Ligjeve në lidhje me zyrat vendore dhe me pushtetin lokal. Ku qëndron problemi? Ose ne duhet të kemi buxhet që të marrim zyra me qira për të hapur zyrat vendore, dhe këtë na thonë vendorët, ose do të zbatohet detyrimi i vënë në ligj. Ligji për Avokatin e Popullit thotë: “Ambientet e zyrave vendore jepen nga pushteti lokal”. Ne e kemi të pamundur të paguajmë para, sepse nuk kemi buxhet, por na ndalon edhe ligji. Nga ana tjetër, ata e kanë detyrim ligjor, por nuk kanë ambiente. Kështu që duhet gjetur një zgjidhje për këtë çështje.

Ne mbahemi te fakti që ju e keni detyrim ligjor, ne paguajmë stafin, sigurisht nëpërmjet buxhetit që na mundësoni, sepse ne nuk mund të bëjmë gjëra për të cilat nuk kemi buxhet, por nga ana tjetër, duhet të kihet vëmendje më e madhe nga disa zyra për këtë çështje. Për shembull, zyra e Sarandës na njoftoi dhe tha: “Merrni masat, merrni rrobat dhe ikni”. Kjo ishte! Ne i dërguam prapë një përgjigje të dytë, të tretë, domethënë luftojmë dhe përpiqemi çdo ditë për të pasur një zyrë, kur flasim “një zyrë” mund të jetë vetëm një tavolinë për të marrë ankesat. Në disa bashki kemi zyrë, por në disa bashki si Pogradeci apo në Kukësi, duke qenë se ajo zyrë iu dha KZAZ-së, na thanë brenda ditës të merrnim materialet, lekat gjithçka dhe të ikni. Në Kukës do të shkonim te një zyrë e madhe që ishte *open space*, ku di unë për sa veta, dhe prapë se prapë, duke u munduar për të gjetur gjuhën e përbashkët dhe zgjidhjen e problemit.

Në zyrën e Fierit përfaqësuesja jonë ka ndenjur në korridor prej 6 muajsh, sepse po bëhej rikonstruksioni i zyrave dhe nuk kishte vend fizik, megjithatë po e them...

Ulsi Manja – Zonja Avokate, më falni që po ju ndërpres!

Nuk mendoj se thelbi i raportimit në Komisionin e Ligjeve është se ku do të rrijë ndihmëskomisioneri dhe komisioneri. Jemi këtu (u tërheq vëmendjen shërbimeve të Kuvendit) saktësisht dua atë çfarë ka manuali i raportimeve për të cilën kemi rënë dakord edhe në takimin që ka pasur Kryetari i Kuvendit me të gjithë drejtuesit e institucioneve kushtetuese të krijuara me ligj. Ka një limit kohor për raportimin dhe raportohet, kjo është rezoluta që deputetët kanë votuar në seancë për Avokatin e Popullit, këto janë përmbushur e këto jo.

Natyrisht, interesit të shtuar të kolegëve për pyetje që ndoshta nuk kanë të bëjnë me raportimin për vitin 2018, është në çështjen e diskrecionit për t’u dhënë përgjigje, por jo për të bërë analizën vjetore të institucionit që ju drejtoni. Atë analizë e keni bërë me stafin tuaj dhe është pjesë e veprimtarive tuaja normale. Ju lutem, fokusohuni te problematikat që kanë brendi, kanë thelb për qytetarët dhe për opinionin publik, aq sa keni mundur të bëni, sepse ju jeni një nga institucionet që keni në fushën e përgjegjësisë monitorimin e zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet shtetërore, por jo vetëm, ndaj ju lutem, fokusohuni te kjo, se kjo ka interes për publikun.

Pastaj problematika të tjera se çfarë do të bëjmë në drejtim të zyrave, kemi 7 do t'i bëjmë 12, kemi 2 ndihmëskomisionerë, do t'i bëjmë 4, janë çështje të organizimit dhe funksionimit, të cilat do t'i zgjidhim bashkë me komisionin dhe Kuvendin.

Fokusohuni në këtë drejtim, te pyetjet konkrete.

Erinda Ballanca - Pyetja konkrete kishte të bënte me numrin e zyrave dhe unë shpjegova...

Vasilika Hysi - Nuk është kjo pyetja në lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, edhe me zyrat, unë pyeta: “Çfarë nuk ka bërë konkretisht Kuvendi i Shqipërisë, mekanizmi, që ju arrini në një konkluzion, është e para fare, për të bashkëpunuar më mirë me institucione të qeverisjes së nivelit vendor? Si e keni bërë ju, si keni arritur në këtë rekomandim, çfarë veprimtarie keni ndjekur?”.

Thashë: “Si mund të punojnë përfaqësuesit e zyrave vendore për të qenë sa më pranë qytetarëve?”. Pyetjet janë komplet ndryshe nga përgjigjet që më dhatë. Ju keni të drejtë të përgjigjeni si të doni, por unë nuk po ju marr në pyetje, sepse po mendoj çfarë rekomandimesh do t'ju bëjmë për vitin 2019.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zonja Ballanca.

Erinda Ballanca - Për sa i përket çështjes së Kuvendit dhe adresimit të kësaj problematike në nivel vendor, unë e kam vendosur në raport, për shkak se me gjithë ndërhyrjen tuaj dhe dërgimit të shkresave nuk është përmirësuar gjendja e zyrave tona rajonale. Aksesit i qytetarëve është gjëja e parë për të shkuar, dhe, kur unë them zyra, e kam fjalën se si do të aksesohen qytetarët, dhe këto zyra duhet t'ia bëjnë më të thjeshtë qytetarit për të shkuar atje. Për të marrë mendimin e qytetarëve, përveç zyrave rajonale kemi edhe një aplikacion që e kemi bërë vitin e kaluar, ku secili prej personave mund të çojë ankesat prej celularit. Kemi bërë një aplikacion për të mbledhur mendimin e qytetarëve edhe nëpërmjet këtij aplikacioni. Aksesit i zyrave të qytetarëve, për të cilat kemi ngritur këtë problem, nuk është realizuar jo për fajin tuaj, por, siç e thashë, për shkak të mekanizmave vendorë. Çfarë mund të bënit ju konkretisht? Ose mund të na jepni buxhet që t'i marrim këto zyra në një vend që duam, ose duhet të gjendet mekanizmi që zyrat të jenë të aksesueshme.

Ne kemi një numër shumë të madh ankesash nga zyrat rajonale, pothuajse gjysma e ankesave të të gjithë institucionit, rreth 43 % e tyre, vjen nga këto zyra. Kjo tregon që zyrat rajonale, kaq sa janë, sepse janë vetëm 7 dhe nuk janë në çdo rreth të Shqipërisë, bëjnë punën e tyre nëpërmjet trajtimit të problemeve që kanë qytetarët. Aty punon një person me kohë të

pjesëshme, sepse kështu është mundësia që kemi, i cili merr ankesat, bën këshillimet, ndërsa zgjidhja e problemeve bëhet në qendër nëpërmjet adresimit të këtyre rekomandimeve.

Për sa i përket pyetjes tjetër lidhur me vendimet që dalin jashtë afateve, të cilat gjykata nuk i bën brenda afateve kohore, ne i kemi bërë disa rekomandime Gjykatës së Tiranës në atë kohë, edhe në ministri e kemi ngritur këtë problem dhe ministria, pasi ka marrë rekomandimet tona, ia ka çuar Gjykatës së Tiranës, ku kjo e fundit na ka kthyer një përgjigje ku thuhet: “E kemi të pamundur, pasi nuk kemi staf”. Rekomandimi ynë ka qenë që të bëhet një mekanizëm efektiv, që gjykata ta kuptojë kur i mbarojnë afatet e detyruara secilit prej qytetarëve, në mënyrë që gjykata në mënyrë aktive ose të zgjasë afatin ose ta marrë çështjen kryesisht. Gjykatat na kanë kthyer përgjigje se nuk kanë mekanizma për të bërë një gjë të tillë.

Për vitin 2019 nuk i jemi drejtuar KLGJ-së dhe KLP-së duke qenë se janë organe, të cilat janë ngritur në dhjetor të këtij viti dhe raportimi mban vitin e kaluar. Ju falënderoj shumë që e sollët këtë gjë në vëmendje dhe komisionerja e Sigurisë do ta ketë në vëmendje për ta rinovuar këtë çështje, por gjykatat thonë që me këto stafe e këto kapacitete që kemi, apo me këto *soft ware*, e kemi të pamundur. Ky ka qenë rekomandimi që ne i kemi bërë Ministrisë së Drejtësisë dhe i vetmi veprim që ajo ka bërë është se ua ka çuar gjykatave. Ne i sugjerojmë kësaj ministrie që të ndryshojë rregulloren që ka dhe ta adresojnë këtë. Ne e kemi ngritur si problem që në burgje njerëzve u ka mbaruar afati dhe rrinë akoma. Ky është një problem.

Ky ka qenë një shqetësim që e kemi ngritur. Kur ne ngremë një shqetësim, ndoshta jo gjithmonë e kemi mekanizmin e zgjidhjes, por besoj se duhet gjetur një zgjidhje. Ngritja e problemit, përtej rekomandimit tonë kërkon adresim dhe zgjidhje.

Për sa u përket përmbaruesve, sigurisht që kemi bërë rekomandime individuale qoftë për ta, qoftë për marrje masash, qoftë te Ministria e Drejtësisë, qoftë për të pasur komisione disiplinore për disa nga përmbaruesit dhe vazhdojmë ta bëjmë. Është një numër i madh rekomandimesh, ne mund t’ju dërgojmë një kopje të tyre, por mendojmë se janë adresuar jo pak, por shumë raste dhe vazhdojnë të adresohen.

Vasilika Hysi - Unë bëra një pyetje në fillim, edhe zoti Braho, gjithashtu, lidhur me numrin e ankesave, sepse rezulton që numri i ankesave në institucion është rritur, por shumë prej tyre janë në formën e këshillimeve ose adresimeve se si mund t’i zgjidhin. Ç’do të thotë kjo? Pra, qytetarët nuk e kanë të qartë se me çfarë merret Avokati i Popullit. Keni bërë informim ligjor?

Unë ju kam bërë një pyetje që është shumë esenciale, që ka të bëjë me rolin e Kuvendit. Ju thoni se janë refuzuar dhe numri i rekomandimeve të pranuar është ulur. Mua nuk më rezulton kështu, sepse në 171 rekomandime, janë refuzuar 17, nga të cilat 2 janë për të

njëtin person, 3 janë për leje shpërblyese, 7 janë për përgjysmim tarifash për studentët, që, në parim, kur qeveria bën një VKM që i përgjysmon tarifat, ose për një person keni të njëtin rekomandim që është refuzuar, ose dy herë është rishikim pensioni, nuk do të thotë se gjithmonë ka të drejtë vetëm Avokati i Popullit. Pra, në 171 rekomandime, të refuzohen 17, nuk do të thotë se është rritur numri i refuzimeve të pranuar. Unë kam statistikën e çdo viti dhe, në kuadër të mekanizmit, më rezulton një konstatim jo i drejtë, ndaj mora tabelën e kontrollova një për një. Nuk e di ku keni arritur!

Erinda Ballanca - Ne kemi thënë se është ulur numri i rekomandimeve të pranuar, pra mund të ishin pranuar më tepër, të refuzuara janë 17, që gjithashtu është numër i vogël, nuk kemi thënë që është rritur numri i rekomandimeve të refuzuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo pra, ne themi të pranuar, domethënë janë të ndara dhe kjo është një ndarje që kemi bërë për të adresuar më shumë natyrën e rekomandimeve duke përcaktuar se numri i rekomandimeve të pranuar krahasimisht me vitin e kaluar ka qenë...

Të zbatuara janë 76, nga 93...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e kam me vete statistikën e vitit të kaluar, por do t'ju sjell. Çështjet statistikore nuk i përcaktoj unë, por jam shumë e sigurt që kjo është çështje numrash, sa na janë pranuar vitin e kaluar dhe sivjet. Nuk ka asnjë lidhje.

Ulsi Manja - Zonja Ballanca, shifrat i kanë kolegët dhe Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit ka bërë një raport: në vitin 2017 keni raportuar në Kuvend se ju keni adresuar 188 rekomandime.

Në vitin 2018, 171 rekomandime, pra në vitin 2018 janë ulur me 17 rekomandimet në raport me vitin 2017.

Vijmë te viti 2018: në totalin prej 171 rekomandimeve që keni bërë, 93 rekomandime janë pranuar, 17 janë refuzuar, 5 rekomandime janë ende pa përgjigje dhe 56 janë në proces. Të mbledhura në total nxjerrin shifrën 171 rekomandime. Pra, këto janë shifrat që kanë dalë në mënyrë analitike nga raporti që keni sjellë në Kuvend, por, përtej debatit të shifrave, se ndonjëherë varet si i lexon statistikën dhe shifrat, dhe nëse ka rënë numri i rekomandimeve, personalisht do ta merrja si tregues pozitiv, që institucionet që keni nën monitorim po punojnë mirë, ose nuk funksionon si duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erinda Ballanca - Ne shpresojmë të jetë kjo, që nuk kemi punuar mirë!

Ulsi Manja - Zonja Ballanca, ne përpiqemi të interpretojmë shifrat në kuptimin pozitiv të gjërave, por gjithsesi të mos biem në kurthin e shifrave.

Zonja Hysi kërkon të dijë problematikat në raportin e viteve 2017-2018, që t'i kemi si orientim për vitin 2019 si Kuvend.

Erinda Ballanca - Në fakt, unë këtë adresim do ta bëja, isha duke e bërë.

Lidhur me rekomandimet e refuzuara për vitin 2018, kemi një listë specifike. Ne kemi bërë raportimin tonë në Kuvend çdo 4 muaj, dhe besoj se jemi nga institucionet që bëjnë raportimin në mënyrë të vazhdueshme analitike. Nëse na janë refuzuar rekomandimet që kemi bërë me Ministrinë e Arsimit, para se të bëheshin protestat studentore, mendoj se nuk ka qenë gjë e mirë nga ana e ministrisë, që të na refuzonte rekomandimet, por në bazë të rekomandimeve tona, duhet që të kishte zhvilluar politika përpara se të bëheshin protestat studentore. Ky ka qenë mendimi dhe qëndrimi i institucionit të Avokatit të Popullit, sepse ne kemi qenë gjithmonë dakord për përgjysmim tarifash, që ligji ua ka njohur atyre të drejtën. Çfarë ndodhi në lidhje me këto raste për sa i përket Ministrisë së Arsimit?! Problemi ishte se ligjet e posaçme për personat që kishin probleme me shikimin apo kategori të caktuara i njihnin të drejtën që ta kishin falas, por ligji i arsimit të lartë dhe VKM-ja e nxjerrë nuk parashikonte ndonjë përjashtim dhe ata thoshin që zbatojnë përjashtimin, i cili përcaktohet në VKM. Kjo ka qenë një ndër arsytet që ne kemi bërë rekomandime, duke thënë që duhet të jetë ligji i posaçëm për grupet vulnerabël dhe këto tarifa duhen parë drejt uljes. Këto nuk janë zbatuar dhe ministria ka thënë që, nëse universiteti nuk e ka zbatuar rekomandimin, ne nuk kemi asnjë kompetencë për këtë. Kjo ka qenë mbrojtja e tyre, por e vërteta është që nuk është kjo tërësisht zgjidhja e problemit, sepse zgjidhja u gjet në momentin që u bënë protestat studentore. Qëllimi i institucioneve, si ai yni, shpresoj dhe ai i ministrisë, është që të mos i çojmë njerëzit në protestë. Ky ka qenë një nga shqetësimet që unë kam pasur dhe kam adresuar edhe me ministren e re për të qartësuar dhe për të thënë se duhet të mundohemi të identifikojmë problemet dhe t'i adresojmë.

Një pjesë e rekomandimeve të tjera kishin të bënin me çështje, të cilat lidhen me zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe me ministren e Drejtësisë. Po t'i shikoni pikat 9, 10 dhe 11, të gjitha rekomandimet tona lidhur me protestën e Kukësit janë refuzuar nga secili prej organeve, si nga ministria, ashtu edhe nga policia. Nga KLD-ja, në atë kohë, dhe nga Prokurori i Përgjithshëm, në atë kohë, na është kthyer përgjigje se çështja do të adresohet me krijimin e organeve të reja. Ndërkohë që KLD-ja, në atë kohë, e ka trajtuar rastin dhe ka parë nëse ka pasur ose jo shkelje nga ana e gjyqtarës për mënyrën sesi ajo ka zbatuar ligjin për marrjen e masave në rastin e Kukësit. Këto kanë qenë vërtet raste shumë të rëndësishme, që ne gjykojmë

se duhet të kishin pasur një sensibilitet tjetër nga ana e organeve, për të cilat ne do t'ju dërgojmë raportin e veçantë në Kuvend, në mënyrë që Kuvendi të adresojë dhe të trajtojë më hollësisht këtë gjë.

Lloji dhe natyra e rekomandimeve që nuk janë zbatuar apo që mendohet se janë në proces do të thotë që ka një sensibilitet të rritur nga ana e organeve për të kthyer përgjigje dhe kjo nga fakti që mekanizmi po jep frytet e tij, por prapë përgjigjet vazhdojnë të mbeten të ndryshme nga ato që ne kërkojmë. Kur rastet janë të mëdha, janë problematike dhe kanë sensibilitet politik, përgjigjet që ne marrim janë të paplota, duhet t'u drejtohem me 10 kërkesa, janë në përfundim të afateve ligjore dhe jashtë afateve ligjore, duke na e vështirësuar punën, por ne jemi përpjekur të kemi një raport sa më të mirë dhe personal me të gjitha institucionet e tjera, në mënyrë që ata ta kuptojnë arsyen dhe qëllimin pse ne e kërkojmë informacionin në zbatim të detyrave që ne kemi. Pavarësisht faktit se ne dërgojmë rekomandime në mënyrë të vazhdueshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, që është një nga institucionet që merr më shumë rekomandime prej nesh, ne kemi një raport shumë të mirë me ata, sepse të gjitha gjetjet tona mundohen të jenë konstruktive për të zgjidhur problematikat. Kjo është fryma e bashkëpunimit që duhet të kemi.

Vasilika Hysi – Të gjitha rekomandimet që ju keni bërë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe që rezultojnë të zbatuara pjesërisht kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve. Kur thatë se numri i kërkesave të pranuara ka rënë, unë ju pyeta se të çfarë natyre janë, nuk kërkoja kaq shumë detaje. Nëse kërkesat janë që të mbyllet burgu dhe të bëhet një i ri, nuk mund të bëhet brenda 1 viti, por, nëse ju thoni që të përmirësohen kushtet, ku të gjitha kërkesat e Autoritetit të Parandalimit të Torturës kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve, nga të cilat dy prej tyre janë për leje shpërblyese dhe një për dhunë, nuk mund t'u thuhet të gjitha institucioneve të burgjeve apo çdo institucioni tjetër që brenda 1 muaji apo 2 muajsh të përmirësojnë kushtet dhe ta bëjnë 100%. Në qoftë se ai e ka pranuar pjesërisht dhe ka reflektuar diçka, unë mendoj se kjo është pozitive. Unë pajtohem me atë që thatë ju, që shumica e burgjeve janë për t'u mbyllur, po, është e vërtetë, por nuk mund të thuash që nuk e ka pranuar, sepse varet shumë nga natyra e rekomandimit që bëhet, pasi një njeri që nuk e lexon dhe nuk i njeh burgjet, siç mund t'i njoh unë dhe shumë të tjerë, mund të thotë se çfarë kanë bërë këta. Burgu i Burrelit, i Zaharisë, do të dalë i pambyllur dhe i paplotësuar, ose i plotësuar pjesërisht, sepse nuk është bërë investim për 70-80 vjet. Prandaj unë them se duhet parë edhe natyra e rekomandimeve që bëhen dhe kjo është në kuadër të rezolutës që do të bëjmë.

Erinda Ballanca – Ju faleminderit!

E kuptoj shqetësimin tuaj. Në fakt, kemi dy pjesë të rëndësishme edhe nga pikëpamja e rekomandimeve që ne bëjmë. Këto rekomandime nuk janë bërë për herë të parë, por bëhen për vite me radhë. Pra, ka rekomandime, të cilat janë pranuar dhe adresuar, të cilat i kemi përmendur në pjesën hyrëse, por nuk mund të mos themi që kanë ngelur rekomandime të pazbatuara edhe për çështje buxhetore. Ajo që unë thashë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, të zbatuara është gjë tjetër dhe të pranuar është gjë tjetër. Rekomandimet e zbatuara i kemi ndarë në kolona më vete, në mënyrë që ju të jeni më të qartë, dhe tek të pranuarat janë rekomandime që ata i pranojnë. Prandaj ka një diferencë midis të pranuarave dhe të zbatuarave. Ata e pranojnë që duhen përmirësuar kushtet, por thonë që s'kemi buxhet, ose diçka tjetër, të cilat ne i kemi trajtuar rast pas rast në secilin rekomandim që bëjmë, si për shembull, çfarë kemi lënë detyrë vitin e kaluar, çfarë është zbatuar dhe përse nuk është zbatuar. Nëse rekomandimet janë të natyrës, që varen vetëm nga individi dhe jo nga buxheti, problematikat janë më të rënda, të cilat ua kemi deleguar edhe drejtuesve më të lartë, duke e adresuar problematikën në çdo nivel të hierarkisë përkatëse.

Lidhur me dhunën psikologjike në burgje dhe në komisarate, ne e kemi trajtuar që nuk është e thjeshtë të provohet dhuna në burgje dhe komisarate. Ne kemi pasur qëndrime publike në lidhje me disa raste të pretenduara për dhunë dhe jemi munduar të mbajmë anën e të vërtetës, rolin që ne kemi, pavarësisht perceptimeve që shumë persona mund të kenë. Unë dua të kërkoj që secili prej nesh të marrë informacionin nga burimi. Edhe unë e bëj herë pas here këtë gabim, që u referohem gazetave apo perceptimeve të individëve në lidhje me një çështje, por, për sa u përket qëndrimeve, e mira do të ishte që secili prej nesh të shikonte burimin. Një nga rastet më problematike që ne kemi trajtuar ka qenë rasti i personit në rrethin e Korçës, i cili vdiq në paraburgim. Në fakt, institucioni i Avokatit të Popullit, pavarësisht qëndrimeve të të gjithë personave të tjerë dhe një problematike shumë të madhe që pati lidhur me atë rast, pasi kreu hetimin, rezultoi se ai nuk ishte i dhunuar. Në fakt, kemi marrë pafundësisht mesazhe negative, urrejtjeje, si për shembull, “Çfarë bëni ju, ju s'bëni asgjë”, por e vërteta është që hetimi rezultoi i tillë, që personi nuk kishte vdekur për shkak të ushtrimit dhunës. Pse kishte vdekur?! Ai kishte vdekur, sepse rekomandimet që ne kishim bërë në mënyrë të vazhdueshme për adresimin e problematikës së kujdesit të mjekëve dhe të zileve që duhet të jenë aty në rastet kur njerëzit kanë një problem, nuk ishin zbatuar. Ne flasim gjithmonë për të parandaluar. Kemi pasur një rast ushtrimi dhune në burgun e Fushë-Krujës, të cilin ne e kemi referuar, si dhe raste të dhunës në rrugë nga ana e policëve bashkiakë, të cilat i kemi

adresuar dhe i kemi konstatuar si raste dhune. Këto ishin për vitin e kaluar. Për vitin aktual jemi në proces të disa rasteve, të cilat jemi duke i hetuar dhe do t'i trajtojmë.

Ulsi Manja- Zonja Ballanca, ju lutem, në mënyrë që pyetjet e kolegëve të marrin të gjitha përgjigje, gruponi problematikat, sepse e kemi filluar mbledhjen në 11:15, ora është 13:15 dhe publiku ka filluar t'i harrojë ato që u thanë në fillim. Domethënë, nëse keni mbaruar me pyetjet e zonjës Hysi, mund të thoni që mbaruat, sepse kolegët po presin secili përgjigjet nominale.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Unë kam disa pyetje për të drejtat e fëmijëve, meqenëse është një kapitull i veçantë dhe kemi përparësi edhe për çështjet gjinore. Ndërsa lidhur me politikat dhe buxhetimin e institucionit, nuk e di se kush do të përgjigjet.

Ulsi Manja- Zonja Hysi, nuk do të jetë seanca e fundit dëgjimore që kemi. Natyrisht që të tria pyetjet janë të rëndësishme, por Avokati i Popullit duhet të thirret përsëri në seancë dëgjimore, sidomos lidhur me problematika të caktuara, siç është ajo e respektimit të të drejtave të fëmijëve. Unë ndërhyra, në mënyrë që të gjitha pyetjet të marrin përgjigje dhe përgjigjet t'i referohen saktësisht pyetjes, të mos flitet për të gjithë fushën dhe në fund fare vetëm dy fjalë për pyetjen konkrete. Ju lutem, sa më konkrete përgjigjen! Për shembull, përgjigjja lidhur me zyrat vendore ishte shumë e saktë, sepse e saktësuar që janë 7 zyra, do të ishte mirë të ishin 17, por këto janë mundësitë. 4 pyetje kam bërë unë.

Erinda Ballanca – Ju faleminderit!

Zoti kryetar, meqenëse ju më caktuat radhën, unë fillova nga radha që më caktuat dhe pyetjet tuaja janë në fund, të cilat do t'i adresoj.

Ulsi Manja- Lëri pyetjet e mia, sepse nuk ka rëndësi nëse unë nuk marr përgjigje, e rëndësishme është që të kënaqen kolegët dhe opinioni.

Erinda Ballanca – Unë kam mbajtur shënim 18 pyetje dhe jam duke i trajtuar. Besoj se isha konkrete lidhur me rastet e dhunës që më pyetet. Këto ishin përgjigjet e pyetjeve tuaja. Nëse ju keni ndonjë pyetje që nuk u jemi përgjigjur, më thoni. 3 pyetjet që bëtë kishin të bënin me numrin e rekomandimeve, problematikat në burgje dhe dhunën psikologjike në burgje dhe komisarate. Këto ishin pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lidhur me mbipopullimin në burgje, ne kemi thënë që numri është ulur dhe është adresuar si problematikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e vërtetë, sepse ne kemi edhe raportet e sivjetshme.

Ulsi Manja – Përgjigjja juaj në eter “Nuk është e vërtetë” është joinstitucionale, sepse kjo del nga monitorimi, statistikat dhe shifrat. Edhe po të thoni ju që nuk është e vërtetë ose anasjelltas ministrja e Drejtësisë, kjo është çështje de facto. Edhe unë kam të drejtët të të pyes për diçka. Ju vetë, konkretisht si Avokate e Popullit, a keni shkuar ndonjëherë për monitorim në ndonjë institucion të vuajtjes së dënimit?

Erinda Ballanca – Jo, por kjo nuk do të thotë që ka shkuar ministrja. Kjo nuk ka asnjë rëndësi.

Ulsi Manja- E thashë këtë për të thënë që nuk mund të thuhet e prerë me thikë që është e vërtetë ose nuk është e vërtetë.

Elena Xhina – Pyetja ime lindi si shkak i asaj që edhe vitin e kaluar, kur keni bërë raportimin, kishte një fjali që kishte të bënte me mbipopullimin në burgje dhe mbaj mend që i lamë detyrë Avokatit të Popullit të bënte një studim të trendit të popullimit në burgje për 5 vjetët e fundit, por nuk e pashë në raport. Prandaj, dua një krahasim me vitin 2017 se si është popullimi në burgje dhe cilat janë indekset e studimit apo matjes së këtij niveli.

Ulsi Manja – Është pyetje e njëjtë edhe me atë të kolegut Permeti.

Andi Permeti – Zonja Ballanca, dua ta shtroj këtë pyetje, sepse nga raportimi i ministres së Drejtësisë u duk sikur njerëzit në burgje bëjnë pushime në Maldive dhe jo sikur ka mbipopullim. Kështu që, ju lutem, na jepni një përqindje të saktë lidhur me raportimet tuaja.

Ulsi Manja- Zonja Ballanca, ju lutem, na jepni një përgjigje për këtë pyetje!

Erinda Ballanca – Ne kemi rezultatet e inspektimeve përkatëse që kryejmë. Pra, ne nuk kemi detyrim të mbajmë të dhëna për gjendjen e çdo burgu në çdo moment, por në momentin që ne kryejmë inspektimet, ne kemi një numër të caktuar të burgosurish, që raportojmë se sa janë në atë moment, kemi edhe kapacitetet zyrtare që janë të përcaktuara sipas rregulloreve përkatëse. Këto konstatime ne i kryejmë çdo herë që shkojmë. Mbiipopullimi i burgut të Tepelenës është në raportin tonë, ndërsa numri dhe se si janë gjërat për secilin burg, do t’i trajtojnë ndihmëskomisionerët. Ne mund t’u çojmë edhe një raport të hollësishëm për secilin rast, ku të gjitha rekomandimet që janë dërguar nga MKPT-ja të jenë specifike për secilin rast. Unë nuk mbaj mend secilën shifër në mënyrë të hollësishme, por them se përmirësimi ekziston, është adresuar si problematikë dhe mbipopullimi është ulur. Ulja mund të jetë për arsye të ndryshme, mund të jetë për hapje burgjesh, për ndryshim politikash penale, për shkaqe faljeje e amnistie dhe për rishpërndarje. Të gjitha këto çështje janë në raportin tonë të plotë, të cilin e kemi dërguar.

Për sa i përket çështjes së studimit, që ngriti zonja Felaj, nuk është një detyrë e lënë për ne për të bërë një raportim. Nëse do të na ishte lënë neve si detyrë, sigurisht që do të

përpiqeshim ta bënim, por çështja që ne kemi ngritur dhe kemi trajtuar çdo rast është që kjo është një e dhënë që ne e marrim për çdo burg, në të cilin ne shkojmë. Nëse ju duhen shifrat, mund t'ju japë zonja Xhafa.

Faleminderit!

Ermonela Xhafa – Përshëndetje!

Unë jam Ermonela Xhafa, komisionere e mekanizmit për parandalimin e torturës, ku mbuloj edhe çështjet e burgjeve e komisariateve, sidomos jam e fokusuar në parandalimin e torturës dhe sjelljeve çnjerëzore degraduese.

Nga të gjitha inspektimet që ne kemi bërë mbipopullimi është një problematikë në sistemin penitenciar shqiptar, pasi kemi vënë re që për vitin 2018 kanë rezultuar të jenë 5316 të burgosur dhe të paraburgosur, të shpërndarë në 3096 të dënuar dhe 2220 të paraburgosur.

Viti 2018 ka një ulje prej 5-10%, krahasuar me vitin 2017, shifra e të cilës është 5418. Pra, në vitin 2018 kemi 102 persona të privuar nga liria më pak sesa në vitin 2018.

Qëllimi i inspektimeve tona dhe rekomandimeve tona është që të përmirësojmë kushtet, në mënyrë që edhe këta njerëz të privuar nga liria të kenë të njëjtin trajtim si ata që janë jashtë, përveç kufizimit të lirisë. Ky është qëllimi kryesor yni.

Për sa u takon studimeve, në vitin 2018, OSBE-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ka bërë një studim në lidhje me mbipopullimin në burgje, duke rekomanduar dhe marrjen e masave për dënimeve alternative për uljen e këtij mbipopullimi. Madje, në vitin 2017 Komiteti i Helsinkit ka bërë një studim të veçantë të fokusuar në të gjitha hallkat për mbipopullimin në sistemin e burgjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aktualisht, ka burgje të veçanta me mbipopullime. Si numër, është afërsisht pranë shifrës... Nuk na bëhet e qartë nga Drejtoria e Burgjeve se sa duhet të jetë shifra limit e të dënuarve ose personave, të cilët vuajnë dënimin, por në burgje të veçanta ka mbipopullime, si, për shembull, në atë të Tepelenës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhafa!

Urdhëroni, zoti Përmeti!

Andi Përmeti - Ashtu siç e tha edhe zonja Hysi pak më parë, këto janë gjëra që nuk zgjidhen për 1 vit. Kush pretendon t'i zgjidh për një vit, është çmenduri, nuk është gjë normale.

Zoti kryetar, që ne të kemi një problem konkret dhe ministria e Drejtësisë të vijë këtu dhe paturpësisht të thotë një shifër të ndryshme...

Ulsi Manja – Të lutem, Andi! Ta ndërpreva fjalën, sepse tani kemi një Kod Etik për Sjelljen dhe fjalët “paturpësisht”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arsyeja është, sepse nuk është edhe prezente këtu.

Andi Përmeti - Në rregull, zoti kryetar, po e heq atë fjalë. Në mënyrë të pacipë tha 0%...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zonja Hysi, unë nuk kam ndërprerë njeri! Ajo tha një shifër, që nuk është reale dhe unë po e adresoj si problem. Ju, në qoftë se nuk doni, mos e merrni si problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë ma thoni ju fjalën, meqenëse unë nuk e di, zoti kryetar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk po them pse nuk janë bërë, sepse çdo gjë do kohën e saj dhe ndoshta nuk është faji i askujt dhe kjo duhet të kërkohet, por dezinformimi me këto lloj shifrash, për mua, është problem.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni!

Ermonela Xhafa - Ne i referohemi dhjetorit të vitit 2018. Nuk e di kur e keni pyetur ju ministren.

Andi Përmeti – Para 1 jave.

Ulsi Manja – Zonja Xhafa, sot nuk kemi në analizë ministren e Drejtësisë. Kushdo nga deputetët, që ka nevojë për informacion, për të ballafaquar rekomandimet dhe statistikat, Rregullorja ia jep këtë të drejtë. Bëjini një kërkesë për informacion ministres së Drejtësisë, një kërkesë Avokatit të Popullit, një kërkesë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe një kërkesë Ministrisë së Brendshme, ballafaqoni statistikat e keni të drejtën ta kërkonin në interpelancë ministren e Drejtësisë sa herë të doni. Këto janë mjete që kemi në dorë. Madje, mund ta kërkonin ministren e Drejtësisë për interpelancë për këtë problematikë që ju e çmoni me rëndësi.

Zonja Peka, mund të vazhdoni me përgjigjet e pyetjeve që bëri kolegja Hysi.

Nejla Peka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me pyetjet e zonjës Hysi, ishin tri të tilla.

Pyetja e parë: sa e garantojmë ne aksesin e fëmijëve tek institucioni i Avokatit të Popullit dhe cila është pesha reale e ankesave të tyre? Është e vërtetë që, në shumicën e rasteve, Avokati i Popullit ka të drejtën ligjore dhe kushtetuese për të trajtuar me iniciativën e tij raste, të cilat bëhen publike në medien e shkruar dhe shtypin përditshëm dhe janë rreth 145 ankesa-kërkesa.

Ndërsa në lidhje me numrin e ankesave të drejtuar nga familje, të cilat në strukturën e tyre kanë fëmijë, këto janë rreth 94. Ajo çka po përpiqemi ne në vazhdimësi, dhe që përbën sfidë për institucionin e Avokatit të Popullit, është gjetja e mekanizmave të përshtatshëm, të cilët garantojnë aksesin dhe qasjen e fëmijëve dhe të rinjve adoleshentë në institucionin e Avokatit të Popullit. Kjo referuar edhe dy shtyllave kryesore të misionit tonë kushtetues, atë të mbrojtjes dhe promovimit. Në kuadër të realizimit të promovimit të të drejtave të fëmijëve, ne jemi përpjekur në mënyrë të vazhdueshme, jo vetëm gjatë vitit 2018, por edhe në fillim të vitit 2019, të organizojmë veprimtari promovuese për garantimin e zbatimit korrekt në praktikë të një nga parimeve kryesore të konventës, të nenit 12, po pjesë e legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe pjesëmarrja e vetë fëmijëve, sepse ata kanë të drejtë për t'u dëgjuar dhe për të qenë pjesëmarrës në çdo proces vendimmarrës që i afekton ata drejtpërdrejt. Konkretisht, ne kemi organizuar disa veprimtari promovuese të tilla, si veprimtaria e organizuar vjet me rastin e 1 Qershorit, kur ne lançuan edhe një dokument shumë të rëndësishëm, në formën e një udhëzuesi për procedurat e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe shoqërinë civile, i cili përmban instrumente të sakta dhe konkrete për mënyrën se si fëmijët i drejtohen institucionit të Avokatit të Popullit. Në këtë drejtim, kemi organizuar takime në disa qytete të Shqipërisë, në bashkëpunim me qeveritë e nxënësve apo “*Save the children*”, si në nga partnerët tanë kryesorë me grupin e zërit të të rinjve +16 për ta adresuar, pikërisht këtë lloj udhëzuesi kaq të rëndësishëm.

Ka edhe veprimtari të tjera, të cilat i kemi realizuar. Ndërkohë, gjëja më e rëndësishme është se ne jemi duke punuar dhe shumë shpejt do të kemi edhe lançimin e strategjisë dhe planit të veprimit të seksionit të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve. Në këtë kontekst, edhe në websajtin e këtij seksioni, në një gjuhë të thjeshtë dhe miqësore, ne jemi përpjekur që të kemi një qasje sa më të madhe të fëmijëve dhe të rinjve, të cilat i drejtohen institucionit të Avokatit të Popullit për të adresuar ato shkelje, që ata kanë konstatuar tek organet e administratës publike.

Në lidhje me pyetjen e dytë, për sa i përket zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, natyrisht, e kemi theksuar disa herë që është një nga risitë në reformën e administrimit të drejtësisë penale për të mitur pikërisht miratimi i këtij kodi. E kemi ndjekur në vazhdimësi, sepse jemi pjesë e grupit, e mekanizmit kombëtar për administrimin e drejtësisë penale për të mitur pjesë e strategjisë, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Ajo që kemi konstatuar është se për sa i përket infrastrukturës institucionale dhe infrastrukturës ligjore mbetet ende shumë për t'u bërë. Dimë se janë miratuar rreth 5 vendime të Këshillit të

Ministrave dhe janë në proces 2 të tjera, të cilat do të formëzonin të gjithë kuadrin ligjor të paketës së akteve ligjore, që duhet të dalin në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Po ashtu, për sa i përket vendimit, që është miratuar pak ditë më parë për ngritjen e qendrës së rehabilitimit dhe parandalimit të krimeve të miturit në konflikt me ligjin. Në fakt, ne e kërkuar me forcë dhe na vjen mirë që tashmë po bëhet realitet plotësimi i këtij kuadri me paketën e akteve nënligjore.

Për sa i përket pyetjes për garantimin e aksesit në drejtësi të fëmijëve, natyrisht edhe fryma e kodit ka të bëjë me një qasje të re jo ndëshkuese, por qasje për rehabilitim dhe riintegrim të të miturve në konflikt me ligjin viktime apo dëshmitarë në përditshmëri dhe në jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa u përket institucioneve të përkujdesit social rezidencial, Avokati i Popullit ka hartuar dy raporte të veçanta një raport në vitin 2012...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa u përket problematikave që ne kemi konstatuar...

Vasilika Hysi – Pyetjet tona janë: çfarë rekomandimesh keni bërë, sepse na intereson, pasi ne si deputetë nuk i njohim rekomandimet. Këtu nuk i shikoj që janë rekomandime për këtë çështje, që ne të ndërtojmë punën tonë. Mos harroni se unë jam nënkryetare e grupit të deputetëve “Miq të Fëmijëve” dhe nuk e kam këtë informacion. Këtë e kam kritikë dhe do ta shprehë në rezolutë, që rekomandimet nuk mund të vijnë ditën kur vjen raporti vjetor, por duhet të vijnë në mënyrë sistematike. Bëtë rekomandime, e shikoni që nuk zbatohen menjëherë adresohuni, sepse ju jeni të pranishëm në Kuvend, por adresoni edhe rekomandimin për ta zgjidhur. Unë ndihem shumë keq që ka kaq shumë rekomandime, por nuk e di se për çfarë janë, sepse thoni “kemi bërë rekomandime” dhe nuk adresohen në kohë. Komunikim elektronikë është edhe *email-i* nëse e dërgon zyrtarisht.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Mund ta përmbyllni, zonja Peka.

Nejla Peka – Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa u përket rekomandimeve, që institucioni ka adresuar në lidhje me gjendjen e fëmijëve në institucionet e përkujdesit rezidencial shoqëror publik ose jo, kanë qenë si rrjedhojë e problematikave që ne kemi konstatuar.

Së pari, në këto institucione kemi konstatuar se nuk merren me aspektin e zhvillimit psiko-social, psiko-motor të fëmijëve, me nevojat e tyre me hartimin e planeve sociale, por janë marrë me aspektin fizik.

Gjithashtu, nëpërmjet rekomandimeve tona kemi kërkuar marrjen e masave për nxjerrjen e paketës së akteve nënligjore, në zbatim të ligjit “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, që është edhe një ligj i ri dhe një më të rëndësishmit është hartimi i planit të deinstucionalizimit. Hartimi i këtij plani do t’i jepte zgjidhje pikërisht problematikave të konstatuara nga ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është bërë.

Ne konstatojmë që ky nuk është miratuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Të lutem, zonja Hysi!

Të lutem, zonja Peka, a mund ta përmbyllni?!

Nejla Peka – Dy rekomandimet e tjera kanë qenë për sa u përket ngritjes së kapaciteteve, kualifikimeve dhe trajnimeve profesionale, të cilat lidhen me stafin që shërben, duke pasur parasysh edhe kategorinë e fëmijëve dhe nevojat e tyre, planet sociale të miratuara sipas formatit tip.

Së fundi, e cila është edhe më e rëndësishmja, është marrja e masave për bashkërendimin dhe bashkëkoordinimin e punës së të gjithë strukturave në nivel vendor dhe kjo i referohet kryesisht ngritjes së grupit ndërinstitutional sektorial me përfaqësues nga Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, Inspektorati i Shërbimit Social dhe Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror, të cilët bëjnë të mundur që të identifikojnë rastet për të cilat ne kemi konstatuar problematika.

Në lidhje me legjislacionin e ri për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në fakt fryma e ligjit është qëndrimi për një kohë sa më të shkurtër i fëmijës në një institucion të kësaj natyre. Duke u nisur nga ky fakt, institucioni ynë vjet u është drejtuar 61 bashkive me një shkresë, ku ka kërkuar informacion për mënyrën se si ato e kanë zbatuar konkretisht në praktikë këtë lloj parashikimi ligjor. Pra, masa e fundit, që duhet të ekzistojë, është zhvendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit social-rezidencial dhe aplikimi i dy masave të tjera, pra forcimi i lidhjeve me familjen biologjike apo krijimi i kushteve për gjetjen e mundësive në një familje kujdestare. Kjo edhe për garantimin korrekt të parimit të interesit më të lartë të fëmijës për t’i garantuar atij një zhvillim psiko-social, motor, mirëqenie dhe kështu e me radhë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Peka!

A ka pyetje të tjera, që nuk kanë marrë përgjigje?

Urdhëroni!

Erinda Ballanca – Pyetja e parë: çfarë gjetjesh keni pasur në lidhje me raportin e Kukësit?

Në fakt, kam 3 pyetje, që kanë të bëjnë me protestat aktuale.

Ulsi Manja – Më falni, jepni përgjigje për protestat e Kukësit një herë ose mund t'i bashkoni të dyja bashkë dhe të jepni një përgjigje.

Erinda Ballanca – Në rregull.

Në fakt, për shkak të numrit të madh të protestave që ka pasur në vend gjatë vitit të kaluar, jemi marrë shumë me problemet e tyre. Kapacitet e institucionit tonë për të monitoruar protestat janë të kufizuara. Megjithatë, jemi përpjekur që në 80% të protestave të kishin staf të institucionit, që ka monitoruar protestat. Pra, kanë qenë aty dhe kanë deklaruar se janë nga Avokati i Popullit; janë paraqitur dhe kanë parë problematikat, nëse ka apo nuk ka, në lidhje me të drejtat e njeriut të protestuesve. Sigurisht, e kemi të pamundur që të shkojmë në çdo rreth dhe në çdo qytet, sepse kapacitetet që kemi janë të kufizuara.

Në lidhje me seksionin e veçantë, i cili trajton çdo gjë që ka të bëjë me shkeljen e të drejtave në polici, burgje, prokurori dhe gjyqësor, ne kemi vetëm 5 veta, pra komisioner plus 4 ndihmëskomisionerë, duke përjashtuar MKPT-në. Kjo ka të bëjë me kapacitet dhe duhet ta kuptojmë se sa e mundur është edhe fizikisht për ne që të monitorojmë çdo protestë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Përmeti, kur të mbarojë zonja Ballanca, mund të diskutoni. Pra, pasi të mbarojë me fazën e përgjigjeve, ju keni të drejtën të diskutoni.

Mund të vazhdoni, zonja Ballanca.

Erinda Ballanca – Në lidhje me pyetjen: “A keni ju një raport me shkeljen gjatë mbajtjes në burg të protestuesve?”, ne nuk kemi dalë me një raport përfundimtar, sepse duhet të bëjmë hetimet. Hetimet që ne bëjmë zgjasin, është një procedurë e caktuar, sepse nuk mund të dalim me një konkluzion pa pyetur, jo vetëm qytetarët, që, sigurisht, mund të pretendojnë se janë dhunuar, apo që janë goditur, apo që është ushtruar forcë ndaj tyre, por edhe me përgjigjen e institucioneve, të cilët në çdo rast duhet të na kthejnë një përgjigje lidhur me masat që janë marrë apo me veprimet që ata kanë kryer, pra nëse kanë kryer veprime të dhunshme apo nuk kanë kryer veprime të dhunshme. Ne jemi duke e bërë këtë hetim. Fakti që ne kemi qenë në çdo protestë dhe konkluzionet tona për gjetjet deri në atë fazë të hetimit janë bërë publike në deklaratat që kemi bërë, qoftë në lidhje me dhunën që është ushtruar nëpër protesta, qoftë në lidhje me gazin e hedhur dhe çfarë po ndodh në lidhje me çështjen e gazit, qoftë me zbatimin e protokollit të hedhjes së gazit.

Ashtu siç e kemi parë ne situatën deri më tani, pavarësisht disa kërkesave që ne kemi bërë, përgjigja që na ka ardhur nga ana institucioneve përkatëse ka qenë e paqartë. Pra, nuk ekziston një protokoll në lidhje me sasinë, sepse ky është shqetësimi kryesor që ne kemi. Ne nuk themi që është e ndaluar të hidhet gazi, sepse ata e kanë të lejuar me ligj dhe me VKM hedhjen dhe llojin e gazit që mund të hidhet. Sigurisht, ato janë të blera sipas përcaktimeve ligjore. Por deri tani nuk ka ardhur asnjë informacion dhe asnjë dokument, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme që ne kemi bërë në lidhje me sasinë nëse ka ndonjë mënyrë metodologjike apo parametër për sasinë e hedhjes së gazit.

Jo më larg se javën e kaluar ne kemi bërë një takim në institucion...

Ulsi Manja – Zonja Ballanca, është pjesë e raportimit për vitin 2019. Të lutem, fokusoni te raporti, për të cilën jeni thirrur këtu!

Erinda Ballanca – Më falni, se unë nuk di kujt t’ia prish dhe kujt t’ia ndreq! **Ulsi Manja** – Këtu e drejtoj unë mbledhjen dhe jo ti.

Erinda Ballanca – Jo, unë po jap përgjigjet.

Ulsi Manja - Se çfarë ke bërë ti në mbledhje pardje, është puna jote, mund të bësh edhe nesër mbledhje. Të lutem, fokusoni te viti 2018, te protesta e Kukësit e vitit 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto të tjerat janë konkluzione pa hetim. Ju vetë po thoni që jemi në fazën e hetimit administrativ, ndërkohë arrini në konkluzione paraprake.

Ju lutem, për seriozitetin e kësaj seancë dëgjimore dhe durimin që kolegët kanë gati 3 orë, pra fokusohuni tek objekti i raportimit që keni dhe për të cilën jeni këtu.

Erinda Ballanca - Zoti Manja, ju mund ta kishit ndaluar të bëhej kjo pyetje dhe unë nuk do të jepja asnjë përgjigje.

Ulsi Manja – Unë nuk ndaloj asnjë pyetje.

Erinda Ballanca – Ju, po më ndaloni mua përgjigjen.

Ulsi Manja – A ka mundësi të fokusoheni te raporti, për të cilën të kemi thirrur? Jepini përgjigje edhe atij kolegu, por nuk besoj se është me interes, kur i mbledh ti atje. Jepini përgjigje, për atë që kërkon deputeti.

Erinda Ballanca – Zoti Manja, kisha një risi, por e çuditshme. Risinë e kemi për tani, sepse kemi vendosur t’i drejtohem për ta gjetur zgjidhje e këtij problemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më pyeti: “Në dijeninë tuaj ka protokoll në lidhje me këtë çështje?”. Unë thashë nuk ka deri tani protokoll, por ne do të mundohemi ta zgjidhim këtë çështje në interes të të gjithëve, të qytetarëve dhe tonin, sepse edhe ne, që po bëjmë këtë hetim, kemi vendosur t’i drejtohem

Komisioneres për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, e cila ka marrë ankesa edhe nga vende të tjera për protesta të ngjashme. Mendoj se kjo është një gjë pozitive, prandaj po e argumentoja, t'i drejtohem dhe të themi se cili është standardi evropian, standardi i Këshillit të Europës për ta trajtuar këtë çështje. Kjo tregon një punë tonën interaktive dhe adresim të problematikave të qytetarëve dhe të shqetësimeve të tyre.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vazhdoni me pyetjen e fundit.

Erinda Ballanca – Në lidhje me ndalimin e hyrjes sime në spital, kjo është çështje, të cilën unë e kam sqaruar atje, për disa minuta jam lënë të pres. Policët e rreshtit të parë nuk ishin në dijeni, folën me shefat brenda, unë qëndrova aty, derisa u lejova për të hyrë. Ndhmëskomisionerët e Avokatit të Popullit nuk u lejuan që të futeshin brenda, edhe pas ndërhyrjes sime. Ishin ndhmëskomisionarët aty, nuk ishte e nevojshme të shkonte Avokati i Popullit, të cilët kanë takuar paraprakisht, para se të shkonte aty zoti Said Dollapi, të gjithë policët e plagosur. I kemi takuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Të lutem!

Erinda Ballanca - Ta mbaroj!

Edhe unë i kam takuar personalisht të gjithë policët e plagosur. Kam pyetur specifikisht për secilin prej tyre, për shkaqet, çfarë dëmtimesh kishin. Kam folur me ta, ka qenë vetëm një vajzë, të tjerët kanë qenë meshkujt. Kam pyetur: “Çfarë protokolli mjekësor kanë pasur?”. Ata i kemi takuar 2 herë, një herë kur nuk ishte zoti Dollapi brenda dhe ne shkuam në kuadër të planit të masave. Shkuam menjëherë në spital. Kjo është pjesa e dytë. Disa grupe monitorojnë protestën gjatë zhvillimit të saj dhe disa grupe monitorojnë komisariatet dhe spitalet për të parë gjendjen e personave të lënduar nga të gjitha anët, qoftë nga protestuesit, qoftë nga ana e forcave të rendit. Po e sqaroj se kemi qenë, jemi lejuar t'i takojmë të gjithë policët e plagosur. Pasi kemi parë të gjithë policët e plagosur dhe jemi larguar, jemi njoftuar në Drejtorinë e Policisë ku kishim shkuar për të marrë informacion për personat e ndaluar se një nga personat e dhunuar publikisht, zoti Dollapi, ishte në spital. Vajzat u rikthyen se nuk i lejuan për të hyrë.

Ulsi Manja - Ju lutem, a ka mundësi ta përmbyllni?

Erinda Ballanca - Unë besoj se duhet të dal pak më tepër publikisht që ta njohë edhe polici i fundit i Gardës fytyrën time, që të më lejojnë herën tjetër.

Ulsi Manja- Bëjeni!

Erinda Ballanca - Është një vërejtje që ia bëj vetes sime.

Ulsi Manja - A ka pyetje?

Zoti Zeneli edhe pse jam në tejkalim të Rregullores, dua të bëni një pyetje të shkurtër, për të garantuar të gjitha hapësirat e lirisë për opozitën.

Alban Zeneli – Megjithëse unë mora pjesërisht përgjigje për pyetjet e mia, por nuk ka asnjë lloj problemi, jam dakord me shumë gjëra që parashtrroi Avokatja e Popullit.

Ju thatë për protokollet që kanë lidhje me përdorimin e gazit nga Policia e Shtetit, për ne dhe për qytetarët është shumë e rëndësishme të dimë, a ekziston një protokoll apo juve nuk ju është dhënë se nuk duan t’ju japin?

Është në dëshirën e Policisë së Shtetit, të uniformave blu që ju personalisht apo të gjithë vartësit tuaj të marrin kontakte me të shoqëruarit, të ndaluarit apo ju keni attribute që t’i takoni ligjërisht?

Ulsi Manja - Faleminderit!

Ju lutem, sa më shkurtimisht!

Erinda Ballanca – Ne kemi attribute për t’i takuar të gjithë personat në të gjitha vendet e privimit të lirisë, pa autorizim të posaçëm, por vetëm duke treguar *badghe*-in e Avokatit të Popullit, pasi kemi të drejtë kushtetuese për ta bërë këtë gjë. Në fakt, në masën më të madhe një gjë e tillë na garantohet, përjashtimet janë shumë të vogla. Gjatë gjithë vitit 2018 kemi hasur në disa pengesa shumë të vogla në një apo dy procese gjyqësore dhe në rastin publik që ju e referuat.

Për sa i përket çështjes së protokolleve, ekziston mundësia e përdorimit të këtij mjeti, të hedhjes së gazit si një mjet për parandalimin e veprimeve të dhunshme apo për të shpërndarë protestën nëse kjo e fundit është e paligjshme, sipas parashikimeve të vetë ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Ajo që nuk kemi gjetur, është se nuk ka një mënyrë të rregulluar të sasisë, pra nuk thuhet; “Për kaq metër katror, kjo është sasia e duhur, për kaq qytetarë, kjo është sasia e duhur”. Këtë nuk e kemi gjetur. Nuk kemi gjetur një dokument dhe ne nuk e kemi, nuk na është raportuar. Ata na thonë: “Nuk ka një dokument që të kufizojë në një mënyrë apo në një tjetër përdorimin e gazit”. Mbetet për t’u provuar në çdo rast nga personat që e kanë hedhur nëse e kanë përdorur këtë mjet në mënyrë proporcionale. Ky është debati që kemi, sepse kjo çështje, në çdo rast duhet të provohet nga ai person që e kryen veprimin, nëse e ka kryer në përputhje me ligjin. Unë nuk kam një mjet tjetër, prandaj e bëra referencën që kisha.

Për sa i përket çështjes së rekomandimeve që nuk keni marrë përgjigje për çështjen e rekomandimeve të Kukësit, të gjitha rekomandimet tona për Kukësin, janë në raport.

Rekomandimet e Kukësit janë të përcaktuara qartësisht. Se çfarë gjetjesh kemi pasur ne, atë do ta sjell në Kuvend përsëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, po flisni pa mikrofon!

Shumë faleminderit, zoti Zeneli!

Zonja Ballanca, a ka pyetje të tjera që nuk kanë marrë përgjigje?

Erinda Ballanca - Po, është bërë një pyetje: a ka pasur apo jo dhunë ndaj studentëve në protestën e tyre? Protesta ka qenë e vitit 2018 dhe nuk kemi raportime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem!

A ka mundësi? Kërkoj zbatimin e Rregullores dhe asgjë tjetër!

Zonjë, mund të vazhdoni me përgjigjet sa të doni, por vetëm shkurt, sepse edhe ju duhet të jeni koshiente se kemi këtu 4 orë. Të gjitha pyetjeve jepuni përgjigje, si të doni ju.

Erinda Ballanca - Zoti Manja, do të mundohem ta përmbledh sa më shumë përgjigjen time.

Në lidhje me pyetjen e 14-të, nëse kemi apo jo rekorde për dhunë gjatë protestave studentore, po ju them se nuk ka asnjë rekord në institucionin e Avokatit të Popullit për dhunë gjatë protestave studentore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem! Nuk ka ndërhyrje tani. Merreni fjalën për diskutim dhe flisni! Nuk është e thënë të merrni përgjigje për të gjitha.

Burrë - Më duket se isha shumë i qartë, nuk e kisha fjalën për dhunën fizike, atë të dukshmen, por ndoshta ka dhunë tjetër, që vjen për arsye të tjera. Për mua është shumë shqetësuese intimidimi edhe politik i studentëve. Nuk ka rëndësi se nga cili krah apo nga cila anë. Ju jeni në dijeni apo keni informacion për dhunë psikologjike, intimiduese, politike e të gjitha me radhë? Ju ka ardhur ndonjë shqetësim për këto? Po apo jo?

Erinda Ballanca - Unë e thashë, se ne nuk kemi rekorde, nuk ka ardhur asnjë person që të paraqesë ankesë qoftë edhe në mënyrë anonime për ta ngritur këtë problem. Nuk kemi asnjë ankesë drejtuar institucionit tonë. Prandaj ne nuk jemi duke trajtuar asgjë të kësaj natyre për këtë rast.

Pyetja në vijim: si i kemi marrëdhëniet me qytetarët? A i presim këta të fundit?

Ulsi Manja - Faleminderit!

Unë kam pyetjet e mia, por më mjafton përgjigjja për këtë pyetje.

Erinda Ballanca - Ne i presim qytetarët në institucion. Unë nuk kam një ditë, se kur mund të vijnë, të paraqiten në institucion, por çdo ditë, gjatë gjithë orarit zyrtar qytetarët paraqiten te ne, takojnë personat te Pritja e Publikut, komisionerët apo ndihmëskomisionerët përkatës, sipas kërkesave të tyre.

Kam edhe dy pyetje të tjera.

Kemi adresimin e çështjeve lidhur me mbrojtjen e konsumatorit që është një problem shumë i madh. Ne kemi një mandat të kufizuar në lidhje me çështjet e mbrojtjes së konsumatorit. Avokati i Popullit nuk ka mandat për të adresuar problemet te shoqëritë private dhe problematikat me mbrojtjen e konsumatorit...

Ulsi Manja - Cili e bëri këtë pyetje?

Erinda Ballanca – Ishte një nga shqetësimet e zotit Braho.

Ulsi Manja – Ka kaluar kohë e gjatë dhe ndoshta nuk e mbaj mend, gjithsesi mund të përgjigjeni.

Erinda Ballanca - Kjo është një çështje për t'u parë. Është një nga risitë e reja të institucionit tonë, edhe përfshirja e problematikave në sektorin privat. Kjo po del si një nga problematikat që po ngrihen, edhe çështjet me karakter gjinor, edhe diskriminimi në punë, në vendet e punës janë duke u ngritur si një problematikë që Avokati i Popullit duhet të ketë një mandat, qoftë të kufizuar për të trajtuar edhe probleme në sektorin privat, gjë që deri sot nuk e kemi.

Motivimi i stafit, ishte një nga pyetjet. Për mënyrën e motivimit të stafit mendoj se ka mënyra nga më të ndryshmet, por më kryesorja është të punohet më tepër sesa stafi. Unë jam në punë një kohë më të gjatë se të gjithë personat e tjerë që punojnë në institucionin e Avokatit të Popullit. Jo për t'u mburrur, në pjesën më të madhe 90% e materialeve të cilat dalin nga institucioni i Avokatit të Popullit edhe nëse nuk mbajnë firmën time, janë dokumente, të cilat i kam lexuar, i kam parë, i kam konsultuar dhe i kam komentuar me secilin prej punonjësve të stafit tim.

Motivim, në gjykimin tim, do të thotë që ti t'u tregosh një standard më të mirë. A kemi mundësi për t'i motivuar nga pikëpamja financiare? Nuk kemi mundësi. A kemi mundësi për t'i dërguar nëpër trajnime? Unë jam përpjekur maksimalisht për t'i dërguar nëpër trajnime, brenda kufizimeve dhe kapaciteteve ligjore që kemi, si edhe kapaciteteve buxhetore. Kam pasur një problem jo të vogël që një pjesë e stafit nuk ka njohur gjuhë të huaja dhe kjo gjë i kufizonte, por duke pasur një qasje të re, pjesa më e madhe e tyre, ka bërë trajnimet përkatëse për të pasur standarde më të larta aktuale.

Kjo ishte pyetja e fundit.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Shumë faleminderit, zonja Ballanca për përgjigjet që dhatë dhe për durimin!

Kolegë, a mund të mbyllim raportimin e Avokatit të Popullit për sot?

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Kam diçka. Duke qenë pjesë e komisionit në 3- 4 mbledhje kam vënë re dy ballafaqime, ose dy ide. Të paktën nga institucionet kushtetuese të tjera që kanë raportuar këtu kam parë një përkëdhelje nga maxhoranca, kurse në rastin konkret shikoj se kishte një ngarkesë. Dy ballafaqime që janë të dukshme dhe për mendimin tim nuk duhet të ekzistojnë, të paktën në Komisionin e Ligjeve. Unë këtë gjë e kam parë, e kam konstatuar, Avokati i Popullit përfaqëson popullin, por institucionet e tjera kushtetuese i keni kaluar pak si shpejt, pa probleme, kurse në rastin konkret keni bërë vërtet opozitë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Të nderuar kolegë, ta mbyllim seancën dëgjimore me Avokatin e Popullit për sot?

Sipas Rregullores, më takon të bëj disa konstatime në emër të komisionit.

Do ta filloj me konstatimin e kolegut Alimadhi, vëmendja ndaj raportimit të Avokatit të Popullit është më e shtuar, sepse më përfaqëson edhe mua, edhe ju, edhe qytetarët. Është Avokati i Popullit, në fund të fundit në stadin final edhe imi, për atë sferë të përgjegjësisë që ia ka ngarkuar ligji: respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe është krejt normale që ne ta marrim edhe nga një këndvështrim tjetër sesi mbrohen të drejtat tona. Kjo është arsyeja, sepse nuk ka tjetër. Njerëzit sot, drejtuesit e institucioneve të pavarura dhe kushtetuese nuk kanë Komisionin e Ligjeve të vetmin medium ku mund të shprehin konsideratat dhe opinionet e tyre, por kanë institucionet e tyre, kanë daljet në medie. Pra, nuk jemi ne e vetmja tribunë ku flasim për problematikat dhe shqetësimet që kanë, por gjithsesi ne jemi institucioni përgjegjës i Kuvendit që monitorojmë veprimtarinë e këtij institucioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi, të lutem!

Zonja Hysi, a ka mundësi?

Edhe kjo është çështje e Rregullores, unë e kam thënë këtë gjë.

Pse ishim sot në këtë seancë dëgjimore kaq të gjatë? Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Komisionit të Ligjeve kërkon të dijë sesi janë përmbushur rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë të lëna me rezolutën e vitit 2018 për Avokatin e Popullit. Janë gjëra praktike që duhet të evidentohen edhe në këtë mbledhje dhe të mbahen shënime nga shërbimet e Kuvendit.

Për vitin 2018 Kuvendi ka lënë 10 rekomandime, ndër të cilat sipas vlerësimit që ka bërë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në raportin e Shërbimit të Monitorimit, i cili u është vënë në dispozicion kolegëve dhe Avokates së Popullit, një rekomandim nuk është përmbushur, është rekomandimi 5, i cili ka të bëjë me angazhimin e përmbushjes së “Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm“, Axfenda 2030, që ka të bëjë me buxhetimin gjinor, me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me mbrojtjen e konsumatorëve, detyrime që burojnë nga legjislacioni në fuqi, në fushat përkatëse dhe\ose në rezolutat e miratuara nga Kuvendi.

Nga pikëpamja e përmbushjes së rekomandimeve të lëna në rezolutën e shërbimeve të Kuvendit evidentojmë se kjo pikë e rezolutës nuk është përmbushur. Por ajo që dua të sjell në vëmendjen e kolegëve të komisionit, por edhe të Avokatit të Popullit, të komisionerëve që janë të pranishëm, në raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2018 nuk ka një evidentim të qartë të angazhimit të institucionit të këtij të fundit për mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në njësitë tona ekstraterritoriale ku zbatohet legjislacioni shqiptar. Këtu e kam fjalën për përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore, se edhe ata janë pjesë e institucioneve tona, sesi shërbimet tona konsullore në detyrim të ligjit shqiptar u ofrojnë shërbimet një pjese të konsiderueshme të shqiptarëve që i kemi jashtë Republikës së Shqipërisë dhe duhet ta keni në vëmendjen e punës suaj të vazhdueshme.

Qytetarët shqiptarë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, edhe këtu në konsullatat tona kanë problematika të përditshme që lidhen me aksesin në shërbime, por edhe me respektimin, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve shqiptarë në Europë, por jo vetëm, aty ku ne kemi shërbimet tona konsullore. Jemi njerëz në fund të ditës. Shkojnë në konsullatat tona për të regjistruar fëmijët që lindin, bashkatdhetarët tanë shkojnë atje për të marrë ekstrakte të gjendjes civile, shkojnë për të marrë vulë dhe kështu me radhë. Do të kërkoja një vëmendje të shtuar të punës së Avokatit të Popullit edhe në këtë drejtim.

Zonja Hysi, kjo duhet të bëhet pjesë e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019. Është një shqetësim që e ka ngritur edhe ministri i Shtetit për Diasporën. Për shtetasit shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit është paraqitur, adresuar edhe në rrugë zyrtare në Kuvendin e Shqipërisë. Unë jo më kot po e nënvizoj që të bëhet pjesë e rezolutës, por kjo nuk do të thotë se Avokati i Popullit ka qenë i kufizuar për ta monitoruar edhe këtë pjesë, jo vetëm me institucionet tona këtu brenda për brenda, por edhe me institucionet homologe që keni në vendet ku kemi konsullata. Do të ishte me shumë interes për komisionin, të dijë, për shembull se çfarë mendon ombudsmani danez në lidhje me përmbushjen e respektimit të të drejtave të qytetarëve shqiptarë në përfaqësitë tona atje. Ju mund ta merrni këtë informacion

edhe nga një opinion i pavarur, përpos që konsullatat tona kanë detyrimin ligjor që t'ju njoftojnë.

Besoj se të gjithë deputetët marrin shqetësime nga qytetarët shqiptarë që jetojnë në Europë për këtë problematikë. Duhet ta evidentoni edhe këtë.

Tjetra, Avokatit të Popullit i kërkohet të vëzhgojë dhe të monitorojë gjithçka. Nuk besoj se gjithë barra e respektimit të të drejtave dhe lirive i bie një institucioni, siç jeni ju, dhe të jeni institucioni i vetëm përgjegjës për këtë pjesë. Jo, sepse shoqëria funksionon si një e tërë dhe e kemi të gjithë për detyrë të kujdesemi për këto probleme, duke filluar nga deputetët, deri te agjencia e fundit.

Kuvendi, ndoshta me pak vonesë, por e plotësoi detyrimin që kishte nga rezoluta për plotësimin e stafit me komisionerë në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit. Kjo u bë e mundur për vitin 2018 dhe ndoshta ndonjë mangësi në punën e institucionit të Avokatit të Popullit mund të ketë ardhur edhe për këtë problematikë.

Zonja avokate, referuar statistikave që ju keni sjellë për vitin 2018, më lejoni telegrafisht të pyes: sa ankesa që janë drejtpërdrejt në kompetencën tuaj keni marrë dhe sa ankesa, që nuk janë në kompetencën tuaj, por që ju keni dhënë orientime dhe këshillime? Po ashtu, sa rekomandime keni prodhuar? Instrumentet ligjore që ju keni në dispozicion janë rekomandimi dhe dhënia e këshillimeve dhe orientimeve për çështje që nuk janë në kompetencën tuaj, por qytetarët shqiptarë vijnë te ju.

Keni marrë 5 mijë e 516 ankesa dhe, (këtë e kam në të ardhmen), po ta pjesëtojmë me numrin e komisionerëve që keni, del të trajtohen 1 mijë e 103 ankesa për komisioner. Pjesëtuar për ditët e punës që ka viti, 1 komisionierë do të trajtojë 3 ankesa në ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Unë bëj analizë statistikore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pjesëtoi ti, sepse mund t'i bësh ndryshe. Ose mund t'i pjesëtojë zoti Haxhimihali, por ç'rëndësi ka?

Nga 5 mijë e 516 që keni marrë, keni thënë se 2 mijë e 100 ankesa janë pjesë e drejtpërdrejtë e veprimtarisë suaj. Mesatarisht i bien 520 ankesa për komisioner, 1,4 ankesa në ditë. Por nuk po bie në kurthin e shifrave, sepse do të ndalem vetëm te rekomandimet, që janë produkt i trajtimit të ankesave. Në finale, produkti i të gjithë veprimtarisë së institucionit që ju drejtoni për vitin 2018, është produkti që prodhoni në fund. Janë 171 rekomandime. Kur flas për rekomandimet që kemi bërë, do t'ju kërkoj që në fokusin e raportimit tuaj në Kuvend, kjo

ngelet të nënvizohet te rezoluta që do të miratojmë, zonja Hysi, të jenë konkrete. Kemi bërë 171 rekomandime, të ndara sipas 10 institucioneve, që rrokin problematikat në burgje, komisarate, prona, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e konsumatorëve. Pra, duhet të kemi një qasje tjetër për mënyrën se si e bëjmë transparencën e punës, jo vetëm të institucionit tuaj, por edhe tonën. Qytetarët shqiptarë duhet ta dinë që Avokati i Popullit ka bërë 171 rekomandime, por në cilat fusha? Cila institucione janë monitoruar? Më pas, ne si Kuvend mund të ndërhyjmë, sepse disa rekomandime të Avokatit të Popullit nuk marrin ose zvarrisin përgjigje dhe duhet të përcaktojmë prioritete. Unë nuk besoj se sot ... Mund të jenë pjesë e raportit, absolutisht, të shpërndara në 108 faqe, siç tha zoti Braho si relator, por opinionin publik, me gjithë transparencën e punës së institucionit tuaj, por edhe tonit, sepse raporti është i botuar, nuk besoj arrin ta marrë të gjithë informacionin. Janë 171 rekomandime. E thashë, mund të jetë pozitiv fakti që ka rënë numri i ankesave dhe rekomandimeve, por gjithsesi, se për çfarë janë bërë këto, mund të na jepni një tablo më të qartë ku i keni.

Këto problematika, nisur nga raporti juaj, nuk i kam konstatuar unë, por Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit. Ka edhe disa problematika të tjera që kanë dalë nga monitorimi i Kuvendit, në kuadër të transparencës, siç është faqja zyrtare e institucionit. Normalisht, marr përsipër pjesën që lidhet me buxhetimin, që duhet të jetë në vëmendjen e Kuvendit, por brenda mundësive dhe kapaciteteve që keni, është mirë që, të paktën, në faqen zyrtare ju t'i keni të publikuara rekomandimet që keni bërë dhe institucionet që keni adresuar. Ta marrim vesh cilat janë institucionet që, le të themi, nuk e vënë ujin në zjarr për rekomandimet që bëni ju.

Tjetra, që është evidentuar si problematikë nga shërbimet e Kuvendit është se duhet të dimë pse janë refuzuar rekomandimet e propozuara dhe cilat janë institucionet që i kanë refuzuar, që të arrijmë në një balancë të qartë, nëse është faji i institucionit, që nuk e ka zgjidhur siç duhet problematikën apo evidenton mosndjekjen siç duhet të rekomandimeve nga ana e Avokatit të Popullit.

Po ashtu, raporti ka disa paqartësi për çështjet e gjetura, që ju i keni nxjerrë jashtë juridiksionit dhe kompetencës suaj. Pra, janë rreth 2915 ankesa, që me të drejtë ndoshta mund të mos jenë në sferën e kompetencës suaj, por duhet t'i di.

Gjithsesi, nisur nga problematika dhe dinamika që ka çështja e respektimit të mbrojtjes dhe lirive të të drejtave të njeriut, këtu kam parasysh të gjitha të drejtat që burojnë nga Kushtetuta, që qytetarëve shqiptarë ua garanton ligji, në pikëpamjen një vlerësimi që bën komisioni, ne e përshëndesim punën pozitive dhe e inkurajojmë Avokatin e Popullit të vazhdojë të punojë duke targetuar realisht problematikat që janë shqetësime të përditshme të qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi.

Zonja Hysi kërkoi të jenë në target kryesor të drejtat e fëmijëve. Patjetër. Kemi një kuadër ligjor. Ndoshta jemi një nga vendet avangardë që kemi Kod Drejtësie për të Mitur. Nuk është pak. Janë bërë hapa në drejtimin e zbatimit, por duhet ta çojmë deri në fund. Ju keni të drejtë të na sugjeroni, se ku ka mbetur dhe pse nuk ecën, që ta dimë dhe ne me çfarë mund të ndërhyjmë dhe si mund t'ju ndihmojë.

Zoti Përmeti dhe zonja Xhina ngritën problemin e sistemit penitenciar. Unë do të isha shumë i lumtur sikur të kishim sa më pak njerëz në burgje dhe në paraburgim, që mbipopullimi në burgje të vijë drejt uljes, pse jo në një eficiencë më të madhe të gjyqësorit, drejt dënimeve alternative, të mos kishim fare njerëz në burg, por kjo është shoqëria.

Kolegë të tjerë ngrenë shqetësimin e protestave. Patjetër, në një sistem demokratik, tubimet dhe protestat janë një e drejtë e garantuar në Kushtetutë. Sigurisht, aty vihen në ekuilibër dhe në balancë të drejtat. Secili ka të drejtë të marrë pjesë në tubim, por edhe të tjerët, që nuk janë dakord, që duan të vazhdojnë jetën, kanë të drejtat e tyre. Avokatit të Popullit i bie pesha dhe përgjegjësia të jetë zëri i të gjitha palëve.

Kur fola për nivelin e bashkëpunimit institucional, zonja avokate, pyetja ime e parë, ishte se cili ishte niveli i raporteve institucionale, dua të sjell në vëmendje vullnetin e mirë, sepse institucioni që drejtoni ju është sa kushtetues dhe ligjor, aq edhe me autoritet moral, por për këtë pjesën e dytë duhet të punoni çdo ditë ju dhe stafi juaj. Niveli i raporteve institucionale përtej ligjit duhet të jetë nivel i vullnetit të mirë.

Jam dakord që Avokati i Popullit nuk merr autorizim paraprak për të monitoruar institucionet e shtetit, por jemi njerëz. Mund të ketë njerëz apo nëpunës publikë edhe që nuk na njohin. Ne jemi vërtet persona publikë, na duket sikur na shikojnë njerëzit sa herë dalim në medie, por ka qytetarë që vazhdojnë jetën e vet morale dhe nuk na njohin, është njerëzore. Një vullnet i mirë i shmang këto lloj skenash, sepse nivelet e bashkëpunimit institucional fillojnë në shumë nivele për të zbritur deri te punonjësi i zbatimit. Këtë kisha parasysh kur fola për nivelin e bashkëpunimit institucional. Duhet të kemi një qasje pozitive, sepse të gjithë jemi për të njëjtin qëllim. Sot ne jemi maxhorancë, nesër do të jemi opozitë, sepse këtë e vendosin qytetarët, por në fund të ditës mbetet respektimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtës së qytetarëve.

Unë ju falënderoj për punën, edhe pse patjetër, disa gjëra bëhen mirë, disa gjëra nuk shikojnë siç duhet, por peshorja anon nga e mira! Ju jeni një nga institucionet që raportoni këtu, do të vijnë edhe të tjerë dhe kanë raportuar edhe të tjerë më parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, zoti Shameti, sepse e mbylla!

Këtu nuk ndaj mendim të njëjtë me kolegët, por personalisht unë dhe kolegët e mi, për disa institucione që kanë raportuar në Komisionin e Ligjeve, qëndrimin e parë e kemi mbajtur nëpërmjet rezolutës me detyrat që kemi lënë, por të jeni të bindur që edhe shkresërisht, në cilësinë e kryetarit të komisionit, kam adresuar shqetësime konkrete për raportimin e disa drejtuesve që kanë ardhur para jush këtu, edhe për vonesa në trajtimin e disa çështjeve dhe sidomos vonesa në vënien në zbatim të legjislacionit të ri në sistemin e drejtësisë. Këtu kam parasysh aktet nënligjore. Kemi reaguar, pavarësisht se disa gjëra bëhen publike dhe disa janë institucionale. Faqja e Kuvendit e pasqyron të gjithë aktivitetin tonë.

Faleminderit ju dhe stafit që drejtoni ju!

Bashkohem me gjetjen e kolegut Shameti, që e ka observuar pjesërisht këtë seancë dëgjimore. Ishte kënaqësi t'ju kishim sot në komision dhe inkurajoj të vazhdojmë bashkëpunimin që kemi pasur. Ne i njohim përgjegjësitë tona, jemi të hapur për çdo sugjerim që ju keni në drejtim të institucionit tonë, qoftë në aspektin ligjor, sepse çështjet mund të jenë edhe të ligjit, edhe në drejtim të buxhetimit siç duhet të këtij institucioni, që për ne është shumë i rëndësishëm, sepse është në trungun e Kushtetutës sonë. Ky institucion është në trungun e Kushtetutës. Nëse të tjerat janë të krijuara me ligj, ju jeni aty, tek ai libri i vogël, por shumë i çmuar, që ka votuar sovrani në vitin 1998.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA